Democracy Plus

# Indeksi i cenueshmërisë ndaj dezinformimit dhe ndikimit malinj të huaj edicioni i 2-të

Qershor, 2024

# INDEKSI I CENUESHMËRISË NDAJ DEZINFORMIMIT DHE NDIKIMIT MALINJ TË HUAJ EDICIONI I 2-të

Vizitoni wefaqen tonë
www.dplus.org

Zbuloni më shumë për publikimin tonë të fundit,
lajmet, infografikat online.

Na gjeni në Facebook
@democracyplus

Na gjeni në LinkedIn
@democracy-plus

Na gjeni në Twitter
@democracy_plus

Na gjeni në Youtube
@Democracy Plus


**Zyrat tona:**

Rruga Bajram Kelmendi, Nr.92, Kati V
Prishtinë, 10000
Kosovë

+383 (0) 38 749 288
info@dplus.org



Ky raport është publikuar nga Demokraci Plus (D +) në kuadër të projektit "Indeksi i cënueshmerisë nga dezinformatat", që mbështetet nga Instituti Kombëtar Demokratik - NDI dhe Agjencioni i Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar - USAID. Përmbajtja e këtij raporti i përket Demokraci Plus dhe jodomosdoshmërisht pasqyron qëndrimin e NDI dhe USAID.

Konceptet kryesore
07

Përmbledhje ekzekutive
08

Gjetjet kryesore
13

Gjetjet kryesore lidhur me domenin e marrëdhënieve ndëretnike:
14

Gjetjet kryesore lidhur me domenin e dezinformimit me bazë gjinore:
16

Gjetjet kryesore lidhur me domenin e peizazhit politik:
18

Gjetjet kryesore lidhur me domenin e peizazhit mediatik:
20

Gjetjet kryesore lidhur me domenin e peizazhit publik:
22

Implikimet për ndryshimet e politikave
24

ANEKSI I – Metodologjia
33

ANEKSI II - Libri i kodeve
42

Kjo faqe është lënë qëllimisht bosh

# Konceptet kryesore

→ Indeksi i cenueshmërisë: Indeksi i cenueshmërisë tregon masën e ekspozimit të një popullate ndaj disa risqeve. Zakonisht, indeksi përbëhet nga indikatorë të shumtë sasiorë që nëpërmjet një formule jep rezultat unik numerik. [1]

→ Cenueshmëria: Në kontekstin e një shteti, kjo përfaqëson ndjeshmërinë ndaj dëmit nga aktorët malinjë shtetërorë ose jo-shtetërorë, të cilët mund të jenë të brendshëm dhe të huaj, bazuar në praninë e vetëm një mangësie ose mangësive të shumëfishta që mund të shfrytëzohen.[2]

→ Çrregullimet e informacionit: Ndarja ose zhvillimi i informacioneve të rreme me ose pa dashjen për të dëmtuar dhe ato kategorizohen si çinformim, dezinformim dhe keqinformim.[3]

→ Dezinformimi: Dezinformimi është kur informacioni i pavërtetë krijohet ose shpërndahet me dashje me qëllimin e shprehur për të shkaktuar dëm. Prodhuesit e dezinformimit zakonisht kanë motivime politike, financiare, psikologjike ose shoqërore.[4]

→ Çinformimi u referohet rasteve kur jepet informacion i pavërtetë, por pa pasur për qëllim të shkaktohet dëm. Për shembull, individët që nuk e dinë se një pjesë e informacionit është e rreme, mund ta shpërndajnë atë në mediat sociale në përpjekje për të ndihmuar.[5]

→ Keqinformimi ndodh kur informacioni i vërtetë shpërndahet me qëllimin për të shkaktuar dëm, shpesh duke publikuar apo bartur në sferën publike informacionin e krijuar për qëllime private.[6]

→ Dezinformimi me bazë gjinore është përhapja e informacioneve dhe imazheve të rreme ose të pasakta kundër grave udhëheqëse politike, gazetare dhe figura publike, për të penguar gratë nga pjesëmarrja në sferën publike.[7]

→ Ndikimi malinj i huaj: Aktorët e huaj të cilët përdorin taktika shpërqendrimi dhe manipulimi për të kufizuar lirinë e shprehjes dhe për të shtrembëruar mjedisin politik demokratik.

→ Platformat digjitale: Platformat digjitale i referohen hapësirave online ku bëhet shkëmbimi i informacionit, si Facebook, Twitter, Linkedin, Instagram dhe TikTok, ndër të tjera.

→ Hapësira digjitale: Koncepti i hapësirës digjitale i përdorur në këtë Indeks është si koncept më i gjerë në krahasim me platformat digjitale dhe i referohet të gjithë informacionit të përhapur në mënyrë digjitale, duke përfshirë platformat e mediave sociale dhe portalet e mediave online.

---

1 Komisioni për Çështje Ekonomike dhe Shoqërore i Kombeve të Bashkuara për Azinë Perëndimore. Në dispozicion këtu https://archive.unescwa.org/vulnerability-index
2 GLOBSEC Vulnerability Index 2021. Extended Methodology. Nëntor 2021. Në dispozicion këtu www.vulnerabilityindex.org
3 Wardle,. C. and Derakhshan., H. (2017) "Information Disorder: Toward an interdisciplinary framework for research and policy making", Raport i Këshillit të Evropës.
4 Po aty
5 Po aty
6 Po aty
7 Konferenca për Integritetin e Informacionit DISICON. "Kuptimi dhe reagimi ndaj dezinformimit me bazë gjinore" Dhjetor 2023. Në dispozicion këtu https://www.ndi.org/sites/default/files/DISICON%20report%20compressed.pdf

# Përmbledhje ekzekutive

Gjatë dy viteve të fundit (2022-2023), prevalenca e dezinformimit ka marrë hov, duke paraqitur kërcënim serioz për demokracinë dhe interesat e sigurisë së Kosovës. Ka disa faktorë që kontribuojnë në këtë çështje: ndikimi malinj i huaj nga Rusia, Kina, dhe në radhë të parë përfaqësuesi i tyre në rajon, Serbia por edhe media të tjera në rajon; mungesa e aftësive të mendimit kritik si rezultat i arsimimit të dobët dhe krahas kësaj edhe edukimit të kufizuar mediatik në mesin e popullatës; dhe polarizimi politik, sidomos gjatë periudhave zgjedhore, mungesa e kapaciteteve qeveritare për të luftuar dezinformimin nga ndikimi malinj i huaj, dhe kapacitetet e dobëta të verifikimit të fakteve. Këta faktorë minojnë aftësinë e qytetarëve për qasje në informacione të paanshme dhe të bazuara në fakte, duke penguar kapacitetin e tyre për të marrë vendime të informuara, duke përfshirë votimin gjatë zgjedhjeve. Në përgjithësi, dezinformimi në Kosovë njihet si çështje e rëndësishme për kombin, duke depërtuar në të gjitha format e mediave, përfshirë edhe mediat tradicionale.

Përhapja e shpejtë e dezinformimit mund të përkeqësojë tensionet me Serbinë dhe madje të nxisë dhunën. Një shembull i kohëve të fundit i kësaj është sulmi në Banjskë në veri[8] të Mitrovicës me ç'rast përhapja e dezinformimit arriti kulmin. Sipas analizave të Institutit Kombëtar Demokratik (NDI) dhe monitorimit të mediave sociale (Facebook dhe Twitter) angazhimi u rrit hovshëm në ditën e sulmit, nga 924 në 33,785 angazhime në ditën e sulmit, ku narrativa dezinformuese lidhur me koordinimin, rolin e Perëndimit dhe foto të të vdekurve u përhapën me intensitet të lartë.

Demokraci Plus publikoi edicionin e parë të Indeksit të cenueshmërisë ndaj dezinformimit në Kosovë në vitin 2022. Studimi zgjoi vëmendje të konsiderueshme dhe dha shkas për bisedë të rëndësishme brenda shoqërisë kosovare lidhur me ndikimin e dezinformimit në demokracinë dhe sigurinë e vendit. Duke u bazuar në këtë, Demokraci Plus po vazhdon me edicionin e dytë të Indeksit për të rritur më tej ndërgjegjësimin e publikut dhe politikëbërësve për sfidat me të cilat përballet Kosova me dezinformimin.

Ky Indeks ofron një vlerësim në shkallë të matshme të cenueshmërisë së Kosovës ndaj dezinformimit, duke vlerësuar situatën aktuale dhe duke identifikuar faktorët kryesorë kontribuues. Qëllimi i këtij Indeksi është të shërbejë si mjet politikash për vendimmarrësit, por edhe si burim informacioni për të kuptuar dinamikën brenda peizazhit mediatik të Kosovës dhe qëndrimet e qytetarëve ndaj çrregullimeve të informacionit dhe ndikimit të huaj, dezinformimit gjinor dhe marrëdhënieve ndëretnike.

Indeksi vlerëson pesë fusha tematike prioritare: 1. Mjedisi mediatik, 2. Peizazhi politik, 3. Perceptimet publike, 4. Dezinformimi me bazë gjinore, dhe 5. Marrëdhëniet ndëretnike. Këto fusha u vlerësuan nga perspektiva e ndikimit malinj të huaj në Kosovë. Këto fusha tematike u përzgjodhën për të shqyrtuar situatën aktuale dhe për të identifikuar faktorë të tjerë të rëndësishëm. Fusha e mjedisit mediatik nxjerr në pah rolin e mediave të pavarura në luftimin e dezinformimit. Në fushën e peizazhit politik vlerësohet ndikimin e dezinformimit në stabilitetin dhe qeverisjen politike. Te perceptimet publike shqyrtohen qëndrimet shoqërore dhe reziliencës ndaj çrregullimeve të informacionit. Ndërkaq fusha e dezinformimit me bazë gjinore

8 Evropa e Lirë. "Sulmi në veri: Kosova bën përgjegjëse Serbinë, Serbia serbët e Kosovës" 25 shtator 2023. Në dispozicion këtu https://www.evropaelire.org/a/sulmi-veri-kosova-pergjegjes-serbine/32607210.html

fokusohet në atë se si dezinformimi synon gratë, duke minuar barazinë gjinore dhe pjesëmarrjen demokratike. Së fundi, në aspektin e marrëdhënieve ndëretnike eksplorohet se si dezinformimi përkeqëson tensionet dhe konfliktet etnike, duke ndikuar në kohezionin social dhe përpjekjet për ndërtimin e paqes.

Në vitet që vijnë, Demokraci Plus planifikon të zgjerojë Indeksin dhe të përfshijë fusha të tjera tematike, për të thelluar vlerësimin gjithëpërfshirës të cenueshmërisë së Kosovës ndaj çrregullimeve të informacionit. Përfaqësimi sasior i cenueshmërisë në secilën fushë tematike ofron perspektivë gjithëpërfshirëse mbi nivelin e cenueshmërisë për secilën fushë dhe mundëson krahasimin e tyre.

Ky Indeks bazohet në tetë burime gjithëpërfshirëse të informacionit (shih Aneksi II). Të gjitha burimet janë përshtatur për të pasqyruar shkallën 0-100, sa më afër 100 aq më e madhe cenueshmëria. Duke përdorur *R* software, secila variabël është rishkallëzuar në mënyrë që rezultatet të llogariten nga totali prej 100. Domenet bien në tri kategori: më pak i cenueshëm (0-33.3), i cenueshëm (33.4-66.6) dhe më i cenueshëm (66.7-100).

Edicioni i dytë i Indeksit të Cenueshmërisë ndaj Dezinformimit (2024) krahasuar me edicionin e parë të Indeksit të Cenueshmërisë ndaj Dezinformimit (2022) tregon se:

→ Domeni i mjedisit politik ka shënuar rritje në vlerësimin e cenueshmërisë nga 45 në 2022 në 56 në 2024, që nënkupton cenueshmëri më të madhe ndaj dezinformimit dhe ndikimit të huaj në çështjet politike.

→ Në mënyrë të ngjashme, në domenin e mjedisit politik, vlerësimi i cenueshmërisë u rrit nga 46 në 55, që tregon cenueshmëri të shtuar në kontekstet që lidhen me mediat.

→ Domeni i perceptimit publik gjithashtu shënoi rritje të dukshme, duke u rritur nga 32 në 45, që sugjeron cenueshmëri më të theksuar të publikut të gjerë ndaj dezinformimit dhe ndërhyrjeve të huaja.

→ Futja e domenit të dezinformimit me bazë gjinore si fushë e re në këtë Indeks zbuloi se është shtylla e dytë më e cenueshme, duke shënuar 59 nga 100 pikë të mundshme.

→ Domeni i marrëdhënieve ndëretnike, i përfshirë gjithashtu rishtazi në këtë Indeks, del si domeni më i cenueshëm, me rezultat prej 69 nga 100 pikë të mundshme.

Marrë parasysh këto trende, në përgjithësi rezultati i cenueshmërisë u rrit nga 41 në 2022 në 57 në 2024, siç tregohet më poshtë, duke reflektuar cenueshmëri më të madhe në fusha të ndryshme ndaj dezinformimit dhe ndikimit malinj të huaj. Kjo tregon nevojën e ngutshme për ndërhyrje dhe strategji me synim për të trajtuar dhe zbutur në mënyrë efektive këto risqe.

| | | INDEKSI 2024 | | INDEKSI 2022 |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Marrëdhëniet ndëretnike | 69/100 | | |
| 2 | Dezinformimi me bazë gjinore | 59/100 | | |
| 3 | Peizazhi politik | 56/100 | ↑ | 45/100 |
| 4 | Mjedisi mediatik | 55/100 | ↑ | 46/100 |
| 5 | Perceptimi publik | 45/100 | ↑ | 32/100 |

**REZULTATI I INDEKSIT**

| INDEKSI 2024 | INDEKSI 2022 |
|---|---|
| 57/100 | 41/100 |




**Indeksi i Cenueshmërisë ndaj Dezinformimit zbulon se Kosova është e cenueshme ndaj dezinformimit dhe ndikimit malinj të huaj në shkallën 579 nga 100.**[10]

# 57/100

9 Numrat janë rrumbulluar për thjeshtësi.

10 Kjo tregon se cenueshmëria ndaj dezinformimit dhe ndikimit malinj të huaj në Kosovë është rritur për 14.6 pikë krahasuar me dy vjet më parë. Edicioni i parë i Indeksit të cenueshmërisë ndaj dezinformimit dhe ndikimit malinj të huaj (2022) me rezultatin 41/100, i disponueshëm këtu https://dplus.org/wp-content/uploads/2022/11/30-12-22_Indeksi-i-cenueshmerise-ndaj-dezinformimit-ne-Kosove.pdf

Indeksi zbuloi se marrëdhëniet ndëretnike në Kosovë përfaqësojnë treguesin më të cenueshëm, ndërsa dezinformimi me bazë gjinore ndjek nga afër. Ndërkohë që peizazhi politik, mjedisi mediatik dhe perceptimi publik rezultojnë të cenueshëm.

# Gjetjet kryesore

# 1 Gjetjet kryesore lidhur me domenin e marrëdhënieve ndëretnike:




Indeksi zbuloi se marrëdhëniet ndëretnike në Kosovë përfaqësojnë treguesin më të cenueshëm, ndërsa dezinformimi me bazë gjinore ndjek nga afër; kjo gjithashtu paraqet nivelin e theksuar të ndasive të brendshme në Kosovë.

Indeksi zbulon se marrëdhëniet ndëretnike janë më të cenueshme ndaj dezinformimit dhe ndikimit malinj të huaj nga të pesë shtyllat e indeksit, duke shënuar 69/100 pikë. Kjo shtyllë vlerëson tre komponentë të peizazhit të marrëdhënieve ndëretnike, marrëdhëniet Kosovë-Serbi (50/100), tensionet ndëretnike (68/100) dhe dezinformimin e huaj me synim (88/100).



Ndikimi malinj i huaj në marrëdhëniet ndëretnike paraqet sfidë të theksuar, duke pasur parasysh se Serbia, dhe në njëfarë mase Rusia, llogarisin në lojalitetin e komunitetit serb për të sfiduar konsolidimin e Kosovës si anëtare e bashkësisë ndërkombëtare të shteteve. Nuk është çudi që përderisa cenueshmëria ndaj dezinformimit në politikë dhe media është rritur që nga raporti i fundit, cenueshmëria në fushën e marrëdhënieve ndëretnike është dukshëm më e madhe.

Komuniteti serb i Kosovës informohet pothuajse tërësisht nga mediat serbe, prej të cilave ato më me ndikim kontrollohen plotësisht nga qeveria gjithnjë e më autoritare në Serbi. Qeveria e Serbisë e ka ashpërsuar qëndrimin ndaj Kosovës dhe kjo është manifestuar edhe me acarim të fjalorit në përputhje me rrethanat.

Gjatë kësaj periudhe, marrëdhëniet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë fillimisht u përkeqësuan, gjë që nxiti një proces të madh ndërmjetësimi. Përpjekjet diplomatike evropiane dhe amerikane çuan në një dokument që synon normalizimin si njohje de facto të Kosovës në këmbim për vetë-qeverisjen e komunitetit serb të Kosovës dhe formalizimin e statusit të Kishës Ortodokse Serbe.

Serbia nuk është pajtuar me paketën, por BE e konsideron atë si të detyrueshme dhe pret që ajo ta respektojë si pjesë të procesit të integrimit të Serbisë në BE. I gjithë procesi u shoqërua me tensione të shtuara, ku serbët e Kosovës u tërhoqën nga institucionet e Kosovës, me inkurajim nga Beogradi. Ndërkohë, Kosova ka rritur kontrollin e saj në veri. Me intensifikimin e përpjekjeve të Qeverisë së Kosovës për konsolidimin e sovranitetit në pjesën veriore të vendit, shkurtimi i pranisë së organeve paralele dhe ilegale të Serbisë brenda Kosovës ka rritur gjithashtu mosbesimin vis-à-vis komunitetit serb.

Tensionet kanë shpërthyer disa herë, duke përfshirë incidente të mëdha ku u plagosën rreth 100 pjesëtarë të KFOR-it, 3 policë të Kosovës u rrëmbyen nga Kosova dhe u dërguan në Serbi dhe incidenti më i madh kur njësitë paramilitare të mbështetura nga Serbia kryen një operacion të madh terrorist që rezultoi me një polic të vdekur.

# 2 Gjetjet kryesore lidhur me domenin e dezinformimit me bazë gjinore:




Indeksi zbulon se dezinformimi me bazë gjinore është i cenueshëm ndaj dezinformimit dhe ndikimit malinj të huaj, duke shënuar 59 pikë nga 100 të mundshme, duke dalë domeni i dytë më i cenueshëm ndër pesë domenet e Indeksit. Kjo shtyllë vlerëson qëndrimet ndaj grave në politikë, gratë dhe edukimin digjital, dhe vlerëson dhunës ndaj grave të lehtësuar nga teknologjia.



Sfidë kryesore mbetet mungesa e legjislacionit adekuat kombëtar që lufton dhe ndëshkon drejtpërdrejt dhunën ndaj grave të lehtësuar nga teknologjia, duke përfshirë dezinformimin me bazë gjinore. Në këtë kontekst, dezinformimi me bazë gjinore përfshin përhapjen e qëllimshme të dezinformimit që synon gratë për shkak të gjinisë së tyre. Rasti më i fundit është grupi "Albkings", një platformë në rrjetin social Telegram, që frikësonte dhe shpërndante foto intime dhe numra telefoni të grave dhe vajzave.[11]

Për më tepër, qëndrimet e qytetarëve ndaj grave në politikë janë më pak të cenueshme në krahasim me vlerësimin e legjislacionit. Megjithatë, zbulohet një hendek domethënës mes gatishmërisë individuale për të zgjedhur gratë dhe bindjes se qytetarët e tjerë janë të gatshëm të zgjedhin gratë. Këto perceptime sugjerojnë se gratë kandidate duken shumë të vështira për t'u zgjedhur. Në veçanti, të dhënat e Indeksit tregojnë se 45% e qytetarëve kanë deklaruar se janë të gatshëm të zgjedhin gratë; megjithatë, ata mendojnë se vetëm 20% e qytetarëve të tjerë janë të gatshëm të zgjedhin gratë.

Gratë dhe edukimi digjital shënojnë 57/100, duke nxjerrë në pah cenueshmërinë ndaj dezinformimit dhe ndikimit malinj të huaj. Mesatarisht, gratë kanë tendenca të moderuara për të besuar në teoritë e konspiracionit. Të dhënat e indeksit tregojnë se edhe ato e perceptojnë veten si jo mjaftueshëm të sigurta në identifikimin se çfarë është reklamë dhe çfarë jo, dhe se si të identifikojnë email-et ose mesazhet në media sociale që përmbajnë vegëza të dyshimta dhe adresa ose emra që ata nuk i dinë.

11 Koha.net. Mbyllet grupi "Albkings", 30 maj 2024. Në dispozicion këtu https://www.koha.net/en/lajmet-e-mbremjes-ktv/421332/mbyllet-grupi-albkings

# 3 Gjetjet kryesore lidhur me domenin e peizazhit politik:

**Gjithsej pikë:**

**56/100**

Indeksi zbulon se peizazhi politik është i cenueshëm ndaj dezinformimit dhe ndikimit malinj të huaj, me rezultatin 56/100, duke dalë domeni i tretë më i cenueshëm ndër pesë domenet e Indeksit. Kjo shtyllë përfshin qëndrimet dhe sjelljet e udhëheqësve politikë, kredibilitetin institucional, cenueshmërinë gjatë politikës së përditshme/zgjedhjeve, si dhe kapacitetin institucional për të menaxhuar dezinformimin e huaj.



Kapaciteti institucional për të menaxhuar dezinformimin e huaj është treguesi më i cenueshëm në këtë domen. Pavarësisht përpjekjeve të qeverisë së Kosovës për të rritur kapacitetet institucionale në këtë fushë, siç është implementimi i Ligjit për Sigurinë Kibernetike[12] dhe ngritja e Qendrës Shtetërore Trajnuese për Sigurinë Kibernetike,[13] ekziston ende mangësi e dukshme në zotësitë administrative për të luftuar në mënyrë efektive kërcënimet kibernetike. Ligji për Sigurinë Kibernetike parasheh themelimin e Agjencisë së Sigurisë Kibernetike; porse kjo ende nuk është bërë. Deri më tani, Ministria e Punëve të Brendshme ka një departament përgjegjës për sigurinë kibernetike dhe administrimin e sistemeve, të emërtuar Departamenti për Siguri Kibernetike dhe Administrim të Sistemeve.[14]

Ngjashëm me rezultatet e edicionit të parë të Indeksit të Cenueshmërisë të botuar në vitin 2022, narrativat e dezinformimit gjatë zgjedhjeve dhe politikës së përditshme mbeten praktika të zakonshme. Kjo përfshin shfrytëzimin e ndasive shoqërore dhe polarizimin përmes përmbajtjes digjitale. Ndër çështjet më të polarizuara në Kosovë radhiten dialogu i normalizimit me Serbinë, Asociacioni i Komunave me shumicë serbe të Kosovës dhe përdorimi i gjuhës mizogjene, veçanërisht gjatë periudhave zgjedhore. Është e rëndësishme të theksohet se ndryshe nga vendet e tjera fqinje si Maqedonia e Veriut ku dezinformimi gjatë zgjedhjeve përqendrohet më shumë në marrëdhëniet ndëretnike dhe sponsorizohet nga aktorë malinjë të huaj, në Kosovë narrativat dezinformuese gjatë zgjedhjeve janë kryesisht të drejtuara nga aktorë të brendshëm.[15]

Për më tepër, qëndrimet dhe sjelljet e udhëheqësve politikë janë më të cenueshme ndaj ndikimit malinj të huaj, duke shënuar 59 nga 100 pikë të mundshme, krahasuar me kredibilitetin institucional, që shënoi 40 nga 100 pikë të mundshme. Kjo tregon se veprimet dhe qëndrimet e udhëheqësve politikë janë më shumë të cenueshme krahasuar me kredibilitetin e institucioneve. Është e rëndësishme të theksohet se cenueshmëria e qëndrimeve dhe sjelljeve të udhëheqësve politikë është rritur nga 35 (Indeksi i 1-rë, 2022) në 59 në këtë edicion të dytë të Indeksit, duke treguar rritje të ndjeshme të cenueshmërisë ndaj dezinformimit dhe ndikimit malinj të huaj. Një nga variablat shpjeguese për këtë janë veprimet e pakoordinuara të qeverisë me Perëndimin, në veçanti ato që kanë të bëjnë me veriun e Kosovës.[16]

---

12 Shih Ligji nr. 08/-173 për Sigurinë Kibernetike, në dispozicion këtu: https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=70933
13 Klan Kosova. "Inaugurohet Qendra Trajnuese për Siguri Kibernetike, Kurti: Arritje domethënëse në këtë rrugëtim. 12 mars 2024. Në dispozicion këtu https://klankosova.tv/inaugurohet-qendra-trajnuese-per-siguri-kibernetike-kurti-arritje-domethenese-ne-kete-rrugetim/
14 Ministria e Punëve të Brendshme. Departamenti për Siguri Kibernetike dhe Administrim të Sistemit, Detyrat dhe përgjegjësitë. Në dispozicion këtu https://mpb.rks-gov.net/f/23/Departamenti-per-Siguri-Kibernetike-dhe-Administrim-te-Sistemeve
15 Intervistë me kryetaren e Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës, Getoarbë Mulliqi. 30 maj 2024.
16 Anketa online me ekspertë nga shoqëria civile dhe komuniteti akademik.

# 4 Gjetjet kryesore lidhur me domenin e peizazhit mediatik:

**Gjithsej pikë:**

**55**
**/100**

Indeksi zbulon se peizazhi mediatik është i cenueshëm ndaj dezinformimit dhe ndikimit malinj të huaj, duke shënuar 55 pikë nga 100 të mundshme dhe duke u radhitur si domeni i katërt më i cenueshëm ndër pesë domenet e Indeksit. Peizazhi mediatik vlerëson lirinë e medias, prevalencën/disponueshmërinë e dezinformimit për publikun, kapacitetin për të menaxhuar keqinformimin/dezinformimin e huaj dhe reziliencën e publikut ndaj keqinformimit/dezinformimit.



Të katër treguesit e përfshirë në këtë shtyllë tregojnë cenueshmëri në rritje krahasuar me vlerësimin e vitit 2022, në edicionin e parë të Indeksit. Prevalenca/disponueshmëria e dezinformimit për publikun dhe kapaciteti për të menaxhuar keqinformimin/dezinformimin e huaj janë treguesit më të cenueshëm. Kjo tregon se dezinformimi perceptohet si prevalent në mediat sociale, mediat private dhe publike, me kapacitete veçanërisht të dobëta institucionale për të menaxhuar këto kërcënime, mes këtyre aktorëve por edhe qeverisë. Falë pranisë së dy partnerëve të verifikimit të fakteve në Kosovë,[17] Facebook-u mund të konsiderohet më efektiv në kontrollin e dezinformimit krahasuar me vitet e mëparshme. Megjithatë, partnerët aktualë të verifikimit të fakteve nuk janë të mjaftueshëm duke pasur parasysh intensitetin e lartë të keqinformimit/dezinformimit që qarkullon në platformë.

Për më tepër, rezilienca e publikut ndaj keqinformimit/dezinformimit mbetet e ulët dhe e dobët, ndërkohë që qytetarët nuk verifikojnë faktet. Në të njëjtën kohë, veçanërisht me risk të lartë ndaj dezinformimit janë qytetarët serbë të Kosovës që lexojnë dhe besojnë portalin e lajmeve të sponsorizuar nga qeveria serbe; ndërsa ky i fundit angazhohet në përhapjen e gjerë të dezinformimit për tema të ndryshme që kanë të bëjnë me Kosovën, me qëllim që, ndër të tjera, ta portretizojë vendin si jostabil.

Në përgjithësi, sistemi arsimor nuk i është nënshtruar asnjë reforme si futja e një kursi të edukimit mediatik/mendimit kritik në arsimin fillor dhe të mesëm, duke kontribuuar në nivelin e ulët të të kuptuarit të lajmeve dhe reziliencën e dobët individuale ndaj keqinformimit/dezinformimit, pavarësisht kërkesave të vazhdueshme nga organizatat e shoqërisë civile. Ngjashëm me dy vite më parë, treguesi më pak i cenueshëm mbetet liria e medias me 32/100 pikë. Kjo sugjeron që, përkundër sfidave dhe cenueshmërive potenciale në fusha të tjera, liria e medias në Kosovë ka mbetur relativisht reziliente ose më pak e prekshme nga ndikimet ose manipulimet e jashtme gjatë periudhës dyvjeçare.

17 Dy partnerët e Facebook-ut për verifikimin e fakteve në Kosovë janë Krypometri në www.kallxo.com dhe www.hibrid.info

# 5 Gjetjet kryesore lidhur me domenin e peizazhit publik:

**Gjithsej pikë:**

**45**
**/100**

Indeksi zbulon se peizazhi publik është i cenueshëm ndaj dezinformimit dhe ndikimit malinj të huaj, me rezultatin 45/100 pikë, por që është domeni më së paku i cenueshëm ndër pesë domenet e Indeksit. Në këtë domen përfshihen pikëpamjet e popullatës kosovare në lidhje me NATO-n, SHBA-në, BE-në, Kinën dhe Rusia-në, besimi në teoritë e konspiracionit dhe në dezinformim, perceptimet e demokracisë, dhe besimi në institucionet.



Po kështu, si në vlerësimin e parë të Indeksit, peizazhi publik mbetet shtylla më së paku e cenueshme duke arritur rezultatin 45/100 pikë. Vlerësimi i favorshëm i popullatës kosovare ndaj NATO-s, SHBA-së, BE-së dhe Kinës ka mbetur i njëjtë, dhe është treguesi më së paku i cenueshëm në të pesë shtyllat. Megjithatë, të dhënat nxjerrin në pah dallime të mëdha në pikëpamjet ndërmjet etnive në popullsinë e Kosovës, ku qytetarët shqiptarë të Kosovës i shohin në mënyrë më të favorshme NATO-n, SHBA-në, BE-në, ndërsa qytetarët serbë të Kosovës i shohin më pak të favorshme fuqitë perëndimore me opinion pozitiv ndaj Rusisë dhe Kinës.

Lidhur me besimet në teoritë e konspiracionit dhe në dezinformim, nuk ka dallime domethënëse në bazë të moshës dhe gjinisë. Megjithatë, shfaqen dallime të ndjeshme mes etnive në lidhje me këto teori konspiracioni. Për shembull, sipas sondazheve të NDI, më shumë se gjysma e qytetarëve serbë të Kosovës pajtohen me teorinë e konspiracionit që ia ngarkon fajin NATO-s dhe BE-së për tensionet në veri të Kosovës, për dallim nga një numër shumë i vogël i qytetarëve shqiptarë të Kosovës që kanë bindje të tilla. Faktori kryesor që ndikon në këto dhe pikëpamjet e lidhura me teoritë e konspiracionit është numri i madh i serbëve të Kosovës që lexojnë dhe besojnë portalet e lajmeve si Sputnik, të sponsorizuara nga Serbia. Sipas sondazheve të NDI, serbët e Kosovës as nuk i lexojnë, as nuk u besojnë mediave me bazë në Kosovë, dhe kryesisht u drejtohen mediave me bazë në Serbi për t'u informuar.

Për më tepër, besimi institucional shënon 54/100 pikë, duke mbuluar besimin e qytetarëve në shtatë institucionet kryesore publike: qeveria, presidenti, mediat, gjyqësori, policia, Forca e Sigurisë së Kosovës dhe partitë politike. Shqiptarët e Kosovës dhe serbët e Kosovës kanë pikëpamje shumë të ndryshme ndaj Forcës së Sigurisë dhe Policisë së Kosovës, ku kjo e fundit shënon nivele më të ulëta besimi dhe cenueshmëri të shtuar ndaj dezinformimit dhe ndikimit malinj të huaj. Kjo mund të shpjegohet kryesisht për shkak të dezinformimit të vazhdueshëm në mediat në pronësi të Serbisë për operacionet e policisë në Mitrovicën e Veriut si operacione të spastrimit etnik dhe operacione kundër serbëve të Kosovës, ndërsa këto operacione policore kanë për qëllim thjesht parandalimin dhe luftimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar.

# Implikimet për ndryshimet e politikave

Rezultati i INDEKSIT të cenueshmërisë u rrit nga 41 në 2022 në 55.6 në 2024, duke treguar rritje të cenueshmërisë në fusha të ndryshme ndaj dezinformimit dhe ndikimit malinj të huaj. Kjo nënvizon nevojën e ngutshme institucionale për ndërhyrje dhe strategji të fokusuara për të trajtuar dhe lehtësuar në mënyrë efektive këto risqe për demokracinë. Është gjithashtu e rëndësishme të theksohet se nuk ka zgjidhje të vetme për dezinformimin, por kundërpërgjigjet efektive institucionale kërkojnë qasje shumëdimensionale duke përfshirë masa të politikave, bashkëpunim me mediat dhe OSHC-të, si dhe koordinim me aktorët ndërkombëtarë.

**Çfarë janë implikimet e kësaj analize?**

1. Anëtarësimi ose niveli i avancuar i bashkëpunimit në/me NATO-n dhe BE-në do të fuqizojë Kosovën që të rrisë reziliencën institucionale ndaj ndërhyrjeve të huaja nga vende si Rusia, Kina, përfaqësuesi i tyre në rajon, Serbia dhe të tjerët.

2. Futja e kurseve të edukimit mediatik/mendimit kritik në të gjitha nivelet e arsimit, duke përfshirë atë fillor, të mesëm dhe universitar, do t'i pajisë nxënësit dhe studentët me njohuritë bazë se si të identifikojnë çdo lloj çrregullimi të informacionit. Krahas kësaj, ndërgjegjësimi i grupeve të ndryshme shoqërore që nuk janë pjesë e sistemit arsimor është thelbësor për qasje gjithëpërfshirëse drejt luftimit të çdo forme të çrregullimit të informacionit qoftë ai çinformim, dezinformim apo keqinformim.

3. Një kuadër ligjor që njeh dhe ndëshkon të gjitha format e dhunës ndaj grave që lehtësohen nga teknologjia është thelbësor dhe urgjent për të luftuar dezinformimin me bazë gjinore.

4. Bashkësia ndërkombëtare do të duhej të intensifikojë përpjekjet për përmbylljen e mosmarrëveshjeve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Do të duhej të bëhen përpjekje për të identifikuar grupet që janë të gatshme të angazhohen drejt një interesi të përbashkët, përtej ndasive etnike (gratë, agjenda e gjelbër, bizneset). Shtrirja e kontakteve në praktikë me komunitetin serb duhet të përmirësohet, si në aspektin e shtrirjes së kontakteve nga ana e qeverisë ashtu edhe në aspektin e kërkesës së komunitetit serb për të marrë shërbimet që i takojnë.

5. Rritja e kapaciteteve të Këshillit të Mediave të Shkruara (KMSH) në Kosovë, si subjekt vetërregullues që mbikëqyr mediat online, është vendimtar për lehtësimin e kundërpërgjigjeve të shpejta ndaj të gjitha ankesave të pranuara. Duke pasur parasysh këtë, KMSH-ja do të jetë në gjendje të monitorojë në mënyrë proaktive përmbajtjen e mediave online duke shërbyer si masë parandaluese kundër çrregullimit të informacionit.

6. Partneritetet ndërmjet aktorëve të ndryshëm duke përfshirë qeverinë, shoqërinë civile, mediat dhe sektorin privat do të rezultojnë në përpjekje më të forta dhe më të konsoliduara drejt parandalimit dhe luftimit të çdo forme të çrregullimit të informacionit.

# 1 Domeni i marrëdhënieve ndëretnike

**Gjithsej pikë:**

**69/100**

Edicioni i 2-të i Indeksit, tregon se domeni i marrëdhënieve ndëretnike është domeni më i cenueshëm, duke shënuar 69 nga 100 të mundshme. Ky domen mbulon kryesisht marrëdhëniet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, tensionet ndëretnike dhe dezinformimin me synim nga aktorët e huaj. Ky i fundit është treguesi më i cenueshëm ndër 18 treguesit e Indeksit.

Dezinformimi shpesh perceptohet si dukuri e re duke pasur parasysh ardhjen e teknologjisë dhe inteligjencës artificiale (shkurt AI, nga gjuha angleze *Artificial Intelligence*). Por propaganda e moçme është e pranishme dekada me radhë, duke përfshirë edhe Ballkanin Perëndimor. Sipërmarrësit etnikë (udhëheqës të cilët kanë shfrytëzuar ndasitë etnike) të viteve 1980 dhe 1990 në ish-Jugosllavi, përdorën në mënyrë intensive teknikat e demonizimit të palës tjetër për t'i portretizuar ata si grup etnik që përbën kërcënim ekzistencial. Teknologjia thjesht ka përforcuar dhe rritur aftësinë e propagandës për të qenë shumë më e fuqishme duke pasur parasysh mjetet e reja teknologjike. Ndërsa supozimi ka qenë se digjitalizimi në rritje do të demokratizojë mediat, rezulton se teknologjia e ka bërë më të lehtë për qeveritë autoritare kontrollin e mediave.

Teknologjia tani ofron mundësinë për të vënë në shënjestër komunitete specifike dhe në Kosovë, Serbia është përpjekur të minojë imazhin e Kosovës në mesin e serbëve të Kosovës, t'i dekurajojë ata të marrin pjesë në institucione, t'i bëjë ata të besojnë se institucionet e Kosovës duan t'i dëbojnë nga Kosova – të gjitha këto për t'i mobilizuar ata kundër Kosovës. Mediat e pavarura janë të prira të mos përdorin propagandë, por shumica e serbëve të Kosovës shikojnë media të kontrolluara nga qeveria serbe dhe shumica e mediave në Serbi janë nën kontrollin e qeverisë.

Pushtimi i Rusisë në Ukrainë ka ngjashmëri të shumta me luftërat e Ballkanit. Arsyetimet e Serbisë dhe Rusisë për të sulmuar vendet fqinje bazoheshin të dyja në: (a) mohimin e historisë së palës tjetër, (b) portretizimin e palës tjetër si inferiore, dhe (c) portretizimin e gjendjes së rëndë të popullatave minoritare serbe/ruse si të kërcënuara nga spastrimi etnik, dhe (d) koreografinë e imazhit të një kryengritjeje edhe kur këto janë veprime të sponsorizuara nga shteti.

Ka arsye për ta parë Serbinë si përfaqësuese të Rusisë, por gjithashtu ka prova të bollshme për të arritur në përfundimin se Serbia vepron në emrin e vet. Për shembull, planet e Serbisë për një "botë serbe" janë materializuar gradualisht me Kuvendin Gjithëserb. Adoptimi i së njëjtës ditë kombëtare nga Republika Srpska me Serbinë është kërcënim madhor i sigurisë për paqen dhe stabilitetin rajonal në Ballkanin Perëndimor.

Ndikimi rus ka rritur gjithashtu mosbesimin e publikut ndaj vaksinave dhe në përgjithësi ka gërryer besimin ndaj vendeve të Perëndimit. Ajo që është interesante të theksohet, është se mediat ruse, si Sputnik, nuk promovojnë narrativa anti-vaksinë brenda Rusisë. Mirëpo, filialet e tyre në Serbi dhe vende të tjera të BE-së e kanë bërë këtë, duke theksuar dashjen malinje që qëndron prapa përhapjes së dezinformimit nga shteti rus.

Sulmi terrorist i Banjskës në shtator të vitit 2023, u pasqyrua shumë ndryshe nga mediat në Kosovë dhe ato të Serbisë dhe vendeve të tjera të rajonit. Në Kosovë u trajtua si terrorizëm paramilitar i sponsorizuar nga shteti serb, ndërsa në Serbi sulmuesit gëzojnë statusin e heronjve. Kjo tregon se si përdoret dezinformimi nga shteti, për të manipuluar dhe radikalizuar publikun përgjatë vijave etnike. Strategjia e dezinformimit nuk është të bëjë keqparaqitjen e fakteve, por të përdorë rrymat e padukshme dhe nivelin e pakënaqësisë midis grupeve.

Mbështetja publike për udhëheqësit autoritarë është rritur në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor, përveç Kosovës dhe Shqipërisë, ku edhe është në rënie atraktiviteti i orientimit joperëndimor. Mbështetja për Vladimir Putin dhe Tayip Erdogan është rritur ndërsa Biden kryeson listën vetëm në Kosovë. Edhe në vendet anëtare të NATO-s, si Maqedonia dhe Mali i Zi, disponimi pro-BE mezi e kalon atë kundër.[18] Ndjenjat anti-BE në përgjithësi shfaqen nga serbët etnikë në shumicën e vendeve të Ballkanit Perëndimor, duke reflektuar nivelin e ndjenjave anti-evropiane që përkrahen hapur nga paria.

Ndikimi malinj i huaj në marrëdhëniet ndëretnike paraqet sfidë më të theksuar sesa në fushat tjera, duke pasur parasysh se Serbia, dhe në njëfarë mase Rusia, llogarisin në lojalitetin e komunitetit serb për të sfiduar konsolidimin e Kosovës si anëtare e bashkësisë ndërkombëtare të shteteve dhe organizatave ndërkombëtare. Nuk është çudi që përderisa cenueshmëria ndaj dezinformimit në politikë dhe media ka pësuar regres që nga raporti i fundit, cenueshmëria në fushën e marrëdhënieve ndëretnike është përkeqësuar.

Dislokimi i shpeshtë i forcave të Serbisë në kufirin me Kosovën dhe inkurajimi për të nxitur mosbindje brenda Kosovës kanë rritur gjithashtu riskun e përleshjeve të armatosura. Shumë vende që kontribuojnë në Forcën e Kosovës (KFOR) e kanë përforcuar praninë e tyre, veçanërisht në pjesën veriore të vendit (Gjermania, Britania e Madhe, Turqia, Bullgaria, Italia, e vende të tjera). Serbia i justifikon lëvizjet e tilla duke i portretizuar serbët e Kosovës si të kërcënuar dhe ekziston frika se ajo po kërkon momentin kur vërtet trupat e saj – potencialisht të maskuar si qytetarë të pakënaqur që rrokën armët – të hyjnë në veri të Kosovës.

Prania e policisë së Kosovës në veri dhe përpjekjet për të goditur praninë ilegale të Serbisë janë shfrytëzuar shumë nga mediat e Beogradit që kërkojnë të gërryejnë imazhin e Kosovës në mesin e serbëve të Kosovës. Marrëdhëniet mes njerëzve të zakonshëm nuk kanë pësuar dukshëm, por besimi i përgjithshëm në mbështetjen në institucionet e Kosovës ka rënë. Këto dhe trende të tjera të opinionit publik janë paraqitur nga seria e Pulsit Publik të UNDP-së por edhe nga një organizatë në veri të Mitrovicës.[19]

Ekziston një vlerësim i përgjithshëm se dezinformimi nga aktorët malinj të huaj synojnë më shumë serbët e Kosovës sesa shqiptarët.

Mediat e sponsorizuara nga qeveria në Serbi përfshihen në dezinformim që përhapet gjerësisht në platforma të ndryshme online. Politika për të treguar Kosovën si shtet të dështuar e portretizon atë si me risk duke shpërfaqur klimë jostabiliteti dhe dyshimi ndërmjet komuniteteve. Keqparaqitja e incidenteve, manipulimi i fakteve synojnë të acarojnë tensionet ndëretnike dhe të minojnë besimin në organet ligj-zbatuese. Siç citohet nga Prishtina Insight (3 qershor 2023), “tha më 17 maj, që këto lloje raportesh shfrytëzojnë marrëdhëniet ndëretnike duke ripublikuar lajme të rreme, duke e bërë të duket sikur situata është gjithmonë jostabile”.[20] Burimet e besueshme të lajmeve zakonisht kanë lexueshmëri të ulët, por mund të jetë lajm pozitiv që në hapësirat ku flitet serbisht, serbët e Kosovës gëzojnë më shumë qasje në lajme të pavarura sesa shumica e serbëve të tjerë në Ballkanin Perëndimor.

18 IRI. Maj 2024 Sondazhi Rajonal i Ballkanit Perëndimor.
19 Surlic, Stefan. Mars 2024. Analiza e trendit. Qëndrimet e komunitetit serb në Kosovë. Aktiv.
20 Prishtina Insight. 23 maj 2024. Disinformation stoking interethnic tensions in Kosovo. (Duhet të gjendet vegëza sepse ky link nuk po punon!) https://shorturl.at/oKUqL

# 2 Domeni i dezinformimit me bazë gjinore

**Gjithsej pikë:**

**59/100**

Edicioni i 2-të i Indeksit zbulon se fusha e dezinformimit me bazë gjinore është shtylla e dytë më e cenueshme, me 59/100 pikë. Ky domen, kap qëndrimet ndaj grave në politikë, gratë dhe edukimin digjital, dhe legjislacionin për dhunën përmes teknologjisë.

Është e rëndësishme të theksohet se përhapja e dezinformimit me bazë gjinore, sjelljes seksiste dhe stereotipave gjinorë dëmton jo vetëm individët/grupet e synuara, por edhe demokracinë. Përdoret si mjet për të heshtur gratë, për të dekurajuar angazhimin e tyre në diskursin politik online, për të formuar perceptimet gjinore dhe për të ndikuar në rolin e grave në demokraci.[21] Kjo çon në dekurajimin ose përjashtimin e gjysmës së popullsisë nga ushtrimi i së drejtës së pjesëmarrjes publike, duke paraqitur kështu kërcënim serioz për demokracinë.

Së pari, Facebook-u dhe Instagram-i janë platformat ku gratë hasin më shpesh dhunën e lehtësuar nga teknologjia. Konkretisht, një në çdo tri gra që kanë përjetuar dhunë të tillë ka raportuar se kjo ka ndodhur në njërën nga këto dy platforma.[22] Sipas të njëjtit raport, në Kosovë, 43.3% e grave kanë përjetuar të paktën një formë të dhunës së lehtësuar nga teknologjia.[23] Një shembull se sa të rrezikuara janë gratë është rasti i fundit dhe tronditës i “Albkings”, një grup ku shumica janë burra, të cilët ndajnë imazhe personale dhe numra të vajzave dhe grave të reja në rrjetin e platformës Telegram. Dhuna online ka shënuar rezultatin më të ulët ndër tre treguesit duke nxjerrë në pah nevojën urgjente për përmirësimin e legjislacionit për të mbrojtur gratë nga dezinformimi dhe format e tjera të dhunës me bazë gjinore në hapësirën digjitale.

Në rend të dytë, më pak të cenueshme krahasuar me vlerësimin e legjislacionit, janë qëndrimet e qytetarëve ndaj grave në politikë. Megjithatë, zbulohet hendek i madh mes gatishmërisë individuale për të zgjedhur gratë dhe bindjes se qytetarët e tjerë janë të gatshëm të zgjedhin gratë, duke sugjeruar se ky perceptim po i bën kandidate gra të duken të pazgjedhshme. Në veçanti, 84% e qytetarëve kanë deklaruar se janë të gatshëm të zgjedhin gratë; megjithatë, ata mendojnë se vetëm 20% e qytetarëve të tjerë janë të gatshëm të zgjedhin gratë.

Për më tepër, edhe pse, 56% e qytetarëve pajtohen ose pajtohen plotësisht se *ngacmimi online dhe portretizimi negativ i grave politikane dekurajon pjesëmarrjen e tyre politike*, dhuna online ndaj grave është e pranishme çdo ditë dhe intensifikohet gjatë zgjedhjeve. Rreth 90% e komenteve të urrejtjes në hapësirën digjitale janë nga burrat drejtuar grave dhe gjenerojnë shkallë më të lartë ndërveprimi në krahasim me lajmet e përgjithshme.[24] Këto komente mizogjene shtohen gjatë kohës së proceseve të rëndësishme politike dhe fushatave të zgjedhjeve, si dhe pasi të ndodhë një femicid.[25]

---

21
22
23
24 Demokracia për Zhvillim (2023). “Mediat jo-sociale. Hulumtimi dhe ekspozimi i dezinformimit gjinor në Kosovë.” Raport monitorimi. Prishtinë, Kosovë.
25 Evropa e Lirë .“Urrejtja e shprehur në internet: Gratë bartin peshën kryesore” 12 shkurt 2024 https://www.evropaelire.org/a/grate-te-pasigurta-online-gjuha-e-urrejtjes-/32815422.html

Së treti, gratë dhe edukimi digjital shënojnë 57/100 pikë, duke sugjeruar se, mesatarisht, gratë kanë tendenca të moderuara për të besuar në teoritë e konspiracionit. Megjithatë, ato nuk ndihen mjaftueshëm të sigurta për të njohur se çfarë është reklamë dhe çfarë jo, kur lexojnë përmbajtje online. Gjithashtu, ato janë më të cenueshme (63/100) në identifikimin e email-eve ose mesazheve në media sociale që përmbajnë vegëza të dyshimta dhe adresa ose emra që ato nuk i dinë.

Në përgjithësi, dhuna me bazë gjinore e lehtësuar nga teknologjia, duke përfshirë ngacmimet online si gjuha mizogjene, përndjekja, dezinformimi dhe gjuha e urrejtjes që synon gratë në politikë dhe diskursin publik, është shumë e përhapur dhe kërkon veprim legjislativ.

# 3 Domeni i peizazhit politik

**Gjithsej pikë:**

**56/100**

Edicioni i 2-të i Indeksit tregon se peizazhi politik është i cenueshëm ndaj dezinformimit dhe ndikimeve malinje të huaja në shkallën 56 nga 100 pikë të mundshme. Kjo e vendos atë si domenin e tretë më të cenueshëm ndër pesë kategoritë e indeksit. Ky domen kap qëndrimet dhe sjelljet e udhëheqësve politikë, kredibilitetin institucional, cenueshmërinë gjatë politikës së përditshme/zgjedhjeve dhe kapacitetin institucional për të menaxhuar dezinformimin e huaj.

Së pari, cenueshmëria gjatë politikës së përditshme dhe gjatë periudhave elektorale është e ndjeshme. Në veçanti, çështjet e natyrës politike duke përfshirë dialogun me Serbinë dhe vendimet e qeverisë për veriun e Kosovës janë dy çështje madhore rreth të cilave vëllimi i dezinformimit që vjen nga aktorë malinj të brendshëm dhe të huaj si Rusia, Kina dhe përfaqësuesi i saj në rajon-Serbia, është i madh dhe ka shënuar rritje të vazhdueshme. Një shembull eklatant është sulmi i Banjskës që u zhvillua më 24 shtator, në Banjskë, në Kosovë. Raportet e monitorimit të NDI tregojnë se çrregullime të informacionit u përhapën tejet gjerësisht në të gjitha mediat sociale dhe kishin për qëllim nxitjen e panikut dhe dhunës masive në atë pjesë të Kosovës. Po kështu, vendimi tjetër i qeverisë që shkaktoi më shumë çrregullime të informacionit ishte masa e reciprocitetit për letërnjoftimet.[26] Inteligjenca artificiale (AI) u përdor gjithashtu për të krijuar fotografi nga konflikte të tjera sikur të ishin duke u zhvilluar në Banjskë. Për më tepër, gjuha e urrejtjes dhe dezinformimi gjithashtu përhapet gjerësisht gjatë periudhave zgjedhore. Sipas monitorimit të kryer nga NDI, zgjedhjet në komunat me shumicë serbe, të mbajtura më 23 prill 2023, u shoqëruan me një numër të lartë të çrregullimeve të informacionit, duke përfshirë gjuhën që promovon ndasitë politike, ngacmimet, gjuhën e ashpër dhe seksiste, gjuhën e urrejtjes, përmbajtjen e manipuluar dhe lajthitëse.

Së dyti, aftësia e institucioneve për të trajtuar dezinformimin e huaj është dëshmuar të jetë aspekti më i cenueshëm i këtij domeni. Kjo është e një rëndësie madhore për një sërë arsyesh, duke përfshirë sigurinë kombëtare, besimin e publikut në institucione, stabilitetin ekonomik, proceset demokratike dhe marrëdhëniet ndërkombëtare. Këto të fundit mund të tensionojnë marrëdhëniet diplomatike dhe të dobësojnë aleancat. Megjithatë, pavarësisht përpjekjeve të qeverisë për të forcuar kapacitetet institucionale në luftimin e dezinformimit, veçanërisht sulmeve kibernetike nga subjektet e huaja, përmes masave si adoptimi i Ligjit për Sigurinë Kibernetike[27] dhe ngritjes së Qendrës Shtetërore Trajnuese për Sigurinë Kibernetike,[28] ekspertët ende i perceptojnë këto kapacitete si të pamjaftueshme, me cenueshmëri të vazhdueshme në nivel të lartë. Për më tepër, disa faktorë të tjerë mundësues të cenueshmërisë ndaj dezinformimit dhe ndikimit malinj të huaj, përfshijnë vendimet e pakoordinuara të qeverisë me Perëndimin, mungesën e kapaciteteve në administratë për të luftuar dezinformimin nga ndikimi malinj i huaj, mungesën e pavarësisë financiare të mediave dhe kapacitetet e dobëta për verifikimin e fakteve.[29]

Së treti, cenueshmëria e qëndrimeve dhe sjelljeve të udhëheqësve politikë është pak më e madhe se ajo e kredibilitetit institucional. Vlen të theksohet se krahasuar me dy vite më parë, cenueshmëria e qëndrimeve dhe sjelljeve të udhëheqësve politikë është rritur lehtë. Mungesa e koordinimit në politikën e jashtme dhe veprimet e shkëputura të qeverisë në lidhje me komunat me shumicë serbe shihen si faktorë kontribues në këtë cenueshmëri.[30]

---

26 D4D. (2022). “Informacioni i çrregullt: Ndikimi i tij tek informimi i qytetarëve”, Raport monitorimi. https://d4d-ks.org/wp-content/uploads/2022/09/D4D_Q3report_Final_SHQ_WEB.pdf.
27 Shih Ligji nr. 08/-173 për Sigurinë Kibernetike, në dispozicion këtu: https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=70933
28 Në dispozicion këtu https://klankosova.tv/inaugurohet-qendra-trajnuese-per-siguri-kibernetike-kurti-arritje-domethenese-ne-kete-rrugetim/
29 Anketa online me ekspertë nga komuniteti akademik dhe shoqëria civile.
30 Anketa online me ekspertë nga komuniteti akademik dhe shoqëria civile.

# 4 Domeni i peizazhit mediatik

**Total vulnerability score:**

**55/100**

Edicioni i 2-të i Indeksit tregon se mediat janë të cenueshme ndaj dezinformimit dhe ndikimeve malinje të huaja në shkallën 55 nga 100 pikë të mundshme. Kjo e vendos domenin e mediave si të katërtin më të cenueshëm ndër pesë fushat e indeksit. Peizazhi mediatik vlerëson lirinë e medias, prevalencën/disponueshmërinë e dezinformimit për publikun, kapacitetin për të menaxhuar keqinformimin/dezinformimin e huaj dhe reziliencën e publikut ndaj keqinformimit/dezinformimit.

Së pari, prevalenca/disponueshmëria e dezinformimit për publikun është treguesi më i cenueshëm i këtij domeni, me 72/100 pikë. Ky tregues qëndron edhe si treguesi më i cenueshëm ndër të gjithë treguesit e tjerë (gjithsej 18) të shpërndarë në pesë shtylla. Dezinformimi njihet si çështje e rëndësishme për kombin, duke depërtuar në të gjitha format e mediave, përfshirë edhe mediat tradicionale.[31] Megjithëse, mediat tradicionale mbeten ende burim më i besueshëm në krahasim me mediat online. Ndërsa ka dallime të vogla në nivelet e cenueshmërisë në mediat online dhe televizionet publike dhe private, ka një aspekt disi më të ndritshëm: cenueshmëria ndaj ndryshimit të qëndrimeve të publikut është pak më e vogël në krahasim me prevalencën e dezinformimit dhe mungesën e edukimit mediatik.

Së dyti, kapaciteti për të menaxhuar dezinformimin e huaj mbetet treguesi i dytë më i cenueshëm në këtë domen. Sipas mendimit të ekspertëve, kapaciteti i institucioneve, në veçanti i mediave, për të menaxhuar kërcënimin nga dezinformimi perceptohet i ulët.[32] Në mënyrë të ngjashme, efektiviteti i Facebook-ut, ndonëse më i mirë në krahasim me vitin 2022, konsiderohet i dobët. Aktualisht, ka 1.1 milion përdorues të mediave sociale, ku Facebook-u është platforma me përdorimin më të madh në Kosovë. Facebook-u ka një partner të palës së tretë për verifikimin e fakteve[33] në Kosovë, por në krahasim me nivelin e përhapjes së çrregullimit të informacionit, është e vështirë të menaxhohet e gjithë kjo. Në përgjithësi, shumimi i shpejtë i platformave online dhe mungesa e kapaciteteve institucionale e ka bërë më të vështirë garantimin e sigurisë së përdoruesve online. Mediat online vetë-rregullohen përmes Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës.[34] Megjithatë, kapacitetet e Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës për të kryer monitorimin *ex-ante* të përmbajtjes online dhe për të shqyrtuar të gjitha ankesat e pranuara janë të mangëta. Për më tepër, Këshilli nuk ka kompetenca detyruese lidhur me vendimet e tij; së këndejmi, funksionaliteti i tij është i kufizuar. Nisur nga ky kontekst, përhapja e dezinformimit bëhet më e lehtë.

Së treti, rezilienca e publikut ndaj dezinformimit shënon 55/100 pikë, duke qenë treguesi i tretë më i cenueshëm në këtë domen, ndërsa liria e medias shënon 32/100 pikë, duke qenë treguesi më së paku i cenueshëm. Në radhë të parë, sistemi arsimor nuk i përgatit qytetarët kosovarë për të identifikuar çfarëdo lloj çrregullimi të informacionit; së këndejmi, ai kontribuon në reziliencën e dobët të publikut ndaj çrregullimit të informacionit. Shkollat fillore dhe të mesme nuk kanë lëndë mësimore të edukimit mediatik/mendimit kritik si pjesë e plan-programeve të tyre. Sipas Programit për Vlerësimin Ndërkombëtar të Nxënësve (PISA), i cili vlerëson aftësinë e nxënësve 15-vjeç në lexim, matematikë dhe njohuri shkencore, nxënësit në Kosovë

31 Anketa online me ekspertë nga komuniteti akademik dhe shoqëria civile.
32 Po aty.
33 Kjo palë e tretë për verifikimin e fakteve është Krypometri. Për më tepër, partnerët për verifikimin e fakteve të certifikuar dhe të njohur ndërkombëtarisht nga IFCN (Rrjeti Ndërkombëtar i Verifikimit të Fakteve) në Kosovë janë: Krypometri dhe Hibrid.
34 Për më shumë informacion, shih uebsajtin e Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës https://presscouncil-ks.org/

dolën me rezultat më të ulët se mesatarja e OECD-së në matematikë, lexim dhe shkencë dhe një përqindje më e vogël e nxënësve në Kosovë, sesa mesatarisht në vendet e OECD-së, dolën në krye të vlerësimit (Niveli 5 ose 6) në të paktën një lëndë, apo arritën nivel minimal të aftësisë (Niveli 2 ose më i lartë) në të tre lëndët.[35] Në radhë të dytë, ndonëse liria e medias shënon rezultatet më të mira në krahasim me treguesit e tjerë, duhet theksuar se Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës ka regjistruar 74 raste të sulmeve ndaj gazetarëve dhe mediave gjatë vitit 2023 dhe ky numër i sulmeve është rritur për 41 në krahasim me vitin 2022.[36] Këto shifra ngrenë shqetësime për lirinë e gazetarisë.

35 Rezultatet e vlerësimit PISA për 2022. Në dispozicion këtu https://www.oecd.org/publication/pisa-2022-results/country-notes/kosovo-1f99d575/#-section-d1e17
36 Intervistë me kryetaren e Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës, Getoarbë Mulliqi. 30 maj 2024.

# 5 Domeni i peizazhit të perceptimit publik

**Total vulnerability score:**

**45/100**

Indeksi i 2-të tregon se peizazhi i perceptimit publik është i cenueshëm ndaj dezinformimit dhe ndikimeve malinje të huaja në shkallën 45 nga 100 pikë. Ky vlerësim vë në pah se ky domen mbetet më i cenueshmi, njësoj si dy vite më parë (Indeksi 2022). Shtylla e peizazhit publik kap pikëpamjet e popullatës kosovare në lidhje me NATO-n, SHBA-në, BE-në, Kinën dhe Rusia-në, besimi në teoritë e konspiracionit dhe në dezinformim, perceptimet e demokracisë, dhe besimi në institucionet.

Së pari, pikëpamjet e popullatës kosovare për NATO-n, SHBA-në, BE-në, Kinën dhe Rusinë mbeten më së paku të cenueshme. Megjithatë, ekzistojnë dallime domethënëse në pikëpamje ndërmjet komuniteteve shqiptare dhe serbe të Kosovës. Në mënyrë të ngjashme me të dhënat e Indeksit të parë, qytetarët shqiptarë të Kosovës i shohin në mënyrë më të favorshme NATO-n, SHBA-në, BE-në, ndërsa qytetarët serbë të Kosovës i shohin më pak të favorshme fuqitë perëndimore me opinion pozitiv ndaj Rusisë dhe Kinës. Ky rezultat, duke pasur parasysh nivelin e cenueshmërisë ndaj dezinformimit dhe ndikimeve malinje të huaja, është dukshëm më i lartë në mesin e komunitetit serb të Kosovës në krahasim me komunitetin shqiptar të Kosovës. Për më tepër, zbërthimi i të dhënave sipas gjinisë nuk zbulon dallime në pikëpamjet dhe votat e grave dhe burrave për këtë indikator.

Së dyti, qytetarët janë të cenueshëm ndaj teorive të konspiracionit dhe dezinformimit në shkallën 54/100. Shfaqen dallime thelbësore mes etnive në lidhje me besimin e teorive të konspiracionit, ndërsa nuk ka dallime në bazë të moshës dhe gjinisë. Për shembull, 55% e qytetarëve serbë të Kosovës pajtohen me teorinë e konspiracionit që ia ngarkon fajin NATO-s dhe BE-së për tensionet në veri të Kosovës, për dallim nga vetëm 16% e qytetarëve shqiptarë të Kosovës që kanë bindje të tilla. Një shembull tjetër, që tregon cenueshmëri të madhe të qytetarëve ndaj dezinformimit, pa marrë parasysh përkatësinë etnike, është pikëpamja e tyre se homoseksualiteti është sëmundje (60% e qytetarëve). Për më tepër, perceptimet e demokracisë janë gjithashtu të cenueshme me 42/100 pikë, pa dallime të mëdha midis etnive, moshës apo gjinisë. Në përgjithësi, sondazhet tregojnë se kosovarët kanë shkallë të lartë të mbështetjes për demokracinë në përgjithësi.[37]

Së treti, besimi në institucione është i cenueshëm në shkallën 54/100 dhe kap besimin e qytetarëve ndaj shtatë institucioneve kryesore duke përfshirë: qeverinë, presidentin, mediat, gjyqësorin, policinë, Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe partitë politike. Në mënyrë domethënëse, shfaqen perspektiva të ndryshme ndërmjet shqiptarëve të Kosovës dhe serbëve të Kosovës në lidhje me Forcën e Sigurisë dhe Policinë e Kosovës, ku këta të fundit tregojnë nivele më të ulëta besimi dhe cenueshmëri më të madhe ndaj dezinformimit dhe ndërhyrjeve të huaja. Nga ana tjetër, pikëpamje të ngjashme të dobëta u konstatuan në lidhje me besimin e partive politike.

37 Raport nga NDI. (2022). "Information Integrity in Kosovo: Assessment of the Political Economy of Disinformation". Në dispozicion këtu https://www.ndi.org/publications/information-integrity-kosovo-assessment-political-economy-disinformation

# ANEKSI I – Metodologjia

## Burimet gjithëpërfshirëse të informacionit

Indeksi i Cenueshmërisë ndaj Dezinformimit bazohet në 10 burime gjithëpërfshirëse të të dhënave:

### 1 Hulumtimi i opinionit publik nga NDI

Në Republikën e Kosovës janë zhvilluar sondazhe përfaqësuese të opinionit në nivel kombëtar dhe rajonal në vitet 2021, 2022 dhe 2023 nga Instituti Demokratik Kombëtar (NDI). Për qëllime të Indeksit janë përdorur një sërë pyetjesh nga anketat e NDI.

### 2 Anketat Online me ekspertët

Demokraci Plus përpiloi një listë ekspertësh nga radhët e shoqërisë civile, komunitetit akademik, gazetarëve dhe zyrtarëve qeveritarë. Secili grup ekspertësh (p.sh., shoqëria civile, komuniteti akademik dhe gazetarët) kishte të paktën 20% përfaqësim në intervista. Lista përfshinte 15 ekspertë, 11 prej të cilëve ishin burra dhe 4 gra. Gjithsej ishin 12 nga komuniteti shqiptar dhe 3 nga komuniteti serb.

### 3 Hulumtimi dokumentar

Hulumtimi dokumentar u krye për të zbuluar nëse ekziston një strategji ose mekanizma të tjerë në dispozicion që qeveria ka përdorur për të menaxhuar dezinformimin, hapësirën e informacionit dhe kërcënimet kibernetike.

### 4 INDEKSI V-Dem

Varietetet e Demokracisë (shkurt V-Dem, nga gjuha angleze *Varieties of Democracy*) është një projekt kërkimor që koncepton dhe mat demokracinë, me bazë në Departamentin e Shkencave Politike në Universitetin e Goteborgut, Suedi.[38]

### 5 Anketa e Pulsit Publik nga UNDP[39]

### 6 Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit i zhvilluar nga Transparency International[40]

### 7 Indeksi Botëror i Lirisë së Shtypit i zhvilluar nga Reporterët pa Kufij[41]

### 8 Indeksi i Edukimit Mediatik i zhvilluar nga Instituti i Shoqërisë së Hapur në Sofje dhe Iniciativa për Politikat Evropiane[42]

### 9 Rezultatet e vlerësimit PISA[43]

### 10 Raporti i UN Women[44]

### 11 Rezultati i Indeksit i E-Pjesëmarrjes i OKB-së[45]

---

38 Varieties of Democracy. Në dispozicion këtu https://www.v-dem.net/
39 UNDP, Pulsi Publik. Në dispozicion këtu https://www.undp.org/kosovo/projects/public-pulse
40 Corruption Perception Index. Në dispozicion këtu https://www.transparency.org/en/cpi/2021?gclid=EAIaIQobChMIyJbMhp-jk-AIVz49oCR1i7QTrEAAYASAAEgI_M_D_BwE
41 World Press Freedom Index. Në dispozicion këtu https://rsf.org/en/rsf%E2%80%99s-2022-world-press-freedom-index-new-era-polarisation-0
42 Media Literacy Index. Open Society Institute Sofia. Në dispozicion këtu https://osis.bg/?p=3750&lang=en
43 Rezultatet e vlerësimit PISA për Kosovën. Në dispozicion këtu https://www.oecd.org/pisa/OECD_2022_PISA_Results_Comparing%20countries%E2%80%99%20and%20economies%E2%80%99%20performance%20in%20mathematics.pdf
44 Raporti i UN Women: "Ana e errët e digjitalizimit: Trajtimi i dhunës ndaj grave që lehtësohet nga teknologjia në Evropën Lindore dhe Azinë Qendrore" https://www.oecd.org/pisa/OECD_2022_PISA_Results_Comparing%20countries%E2%80%99%20and%20economies%E2%80%99%20performance%20in%20mathematics.pdf
45 UN E-Participation Index. Në dispozicion këtu https://publicadministration.un.org/egovkb/en-us/About/Overview/E-Participation-Index

# ANEKSI II - Libri i kodeve

## Libri i kodeve

Në vijim jepet një pasqyrë e pyetjeve që janë përdorur për edicionin e vitit 2024 të Indeksit të Cenueshmërisë ndaj Dezinformimit në Kosovë. Ato fokusohen kryesisht në pesë dimensione të gjera të cenueshmërisë, të cilat zbërthehen më tej nëpërmjet indikatorëve që përmbajnë të dhënat nga anketat dhe të dhëna të agreguara të rëndësishme për dimensionet në fjalë. Nga versioni inaugurues i Indeksit, tre dimensionet e mëparshme të përfshira në vlerësim janë: (1) Qëndrimet e publikut, (2) Peizazhi politik, dhe (3) Mjedisi mediatik. Përveç këtyre, tani kemi shtuar edhe dy dimensione. Këta janë: (4) Dezinformimi me bazë gjinore dhe (5) Marrëdhëniet ndëretnike. Për shumicën e pikave të të dhënave të përfshira, të dhënat janë marrë nga viti më i fundit i disponueshëm për secilin burim, duke detajuar vitin e të gjitha burimeve të të dhënave dhe anketave pranë secilës pyetje të përfshirë. Secili dimension ndahet më tej sipas katër indikatorëve shtesë, ku secili ka 100 pikë në total. Rezultatet totale midis këtyre treguesve mblidhen së bashku dhe pjesëtohen me katër indikatorët për të marrë rezultatin përfundimtar për secilin dimension.

Dy inputet kryesore janë anketat e kryera nga Instituti Demokratik Kombëtar (NDI), të cilat shërbejnë si bazë për indikatorin e qëndrimeve publike, si dhe anketat e Demokraci Plus me ekspertë të kryera nga hulumtuesit në Demokraci Plus, të cilat shërbejnë për të forcuar indikatorët e peizazhit politik, mjedisit mediatik, dezinformimit me bazë gjinore dhe marrëdhënieve ndëretnike. Të dhëna shtesë janë marrë nga disa indekse dhe raporte të tjera. Të dhënat që janë marrë nga këto burime alternative janë etiketuar në mënyrë të ngjashme pranë secilës pyetje të përfshirë.

## Qëndrimet publike

Dimensioni i qëndrimeve publike është nxjerrë tërësisht nga të dhënat e anketave të zhvilluara me porosi nga NDI. Varësisht nga pyetja, versioni më i fundit i secilës pyetje është marrë nga dy anketat kryesore të NDI: Sondazhi Rajonal dhe Sondazhi i Vendit për Kosovën. Për më tepër, për perceptimet e demokracisë, të dhënat janë marrë nga Anketa e Pulsit e Kombeve të Bashkuara në prill 2023. Dimensioni i qëndrimeve publike është ndarë në katër indikatorë të ponderuar në mënyrë të barabartë. Secili është renditur më poshtë së bashku me pyetjet (dhe burimet e tyre) që janë përdorur për të krijuar secilin output. Secili indikator është rishkallëzuar në mënyrë që totalet të llogariten nga totali prej 100.

### 1 Pikëpamjet e popullatës kosovare për NATO-n, BE-në, SHBA-në, Kinën dhe Rusinë

**PYETJA E PARË:** Çfarë mendimi keni për Kinën?
**BURIMI:** Sondazhi i Vendit për Kosovën nga NDI
**SHKALLA:** 1/5 – (1 është Shumë të pafavorshëm dhe 5 është Shumë të favorshëm)

**PYETJA E DYTË:** Çfarë mendimi keni për Rusinë?
**BURIMI:** Sondazhi i Vendit për Kosovën nga NDI
**BURIMI:** 1/5 – (1 është Shumë të pafavorshëm dhe 5 është Shumë të favorshëm)

**PYETJA E KATËRT:** Çfarë mendimi keni për Shtetet e Bashkuara?
**BURIMI:** Sondazhi i Vendit për Kosovën nga NDI
**SHKALLA:** 1/5 – (1 është Shumë të favorshëm dhe 5 është Shumë të pafavorshëm)

**PYETJA E PESTË:** Çfarë mendimi keni për NATO-n?
**BURIMI:** Sondazhi i Vendit për Kosovën nga NDI
**SHKALLA:** 1/5 – (1 është Shumë të favorshëm dhe 5 është Shumë të pafavorshëm)

**PYETJA E GJASHTË:** Sikur këtë të diel të mbahej referendumi për anëtarësimin e vendit tuaj në BE, si do të votonit?
**BURIMI:** Sondazhi Rajonal nga NDI
**SHKALLA:** 1-4 – Absolutisht për / Mbase për / Mbase kundër / Absolutisht kundër

**PYETJA E SHTATË:** Sikur këtë të diel të mbahej referendumi për anëtarësimin në NATO, si do të votonit?
**BURIMI:** Sondazhi Rajonal nga NDI
**SHKALLA:** 1-4 – Absolutisht për / Mbase për / Mbase kundër / Absolutisht kundër

## 2 Besimi në teoritë e konspiracionit dhe dezinformim

**PYETJA E PARË:** A mendoni se disa uebsajte/portale të lajmeve online raportojnë ndonjëherë informacion të rremë apo jo?
**BURIMI:** Sondazhi i Vendit për Kosovën nga NDI
**SHKALLA:** 1-3 – Jo, nuk e bëjnë këtë/Po, herë pas here/Po, rregullisht

**PYETJA E DYTË:** A i besoni thënies së mëposhtme: "Homoseksualiteti është çrregullim apo sëmundje"
**BURIMI:** Sondazhi i Vendit për Kosovën nga NDI
**SHKALLA:** (0/1) Nuk pajtohem plotësisht, Nuk pajtohem, Neutral – Pajtohem, Pajtohem plotësisht

**PYETJA E TRETË:** A i besoni thënies së mëposhtme: "Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe do të bëhet Republika Srpska e re në Kosovë"
**BURIMI:** Sondazhi i Vendit për Kosovën nga NDI
**SHKALLA:** (0/1) Nuk pajtohem plotësisht, Nuk pajtohem, Neutral – Pajtohem, Pajtohem plotësisht

**PYETJA E KATËRT:** A i besoni thënies së mëposhtme: "NATO dhe BE janë fajtore për tensionet në veri të Kosovës"
**BURIMI:** Sondazhi i Vendit për Kosovën nga NDI
**SHKALLA:** (0/1) Nuk pajtohem plotësisht, Nuk pajtohem, Neutral – Pajtohem, Pajtohem plotësisht

**PYETJA E PESTË:** A i besoni thënies së mëposhtme: "Partnerët ndërkombëtarë po e ndëshkojnë gabimisht Kosovën"
**BURIMI:** Sondazhi i Vendit për Kosovën nga NDI
**SHKALLA:** (0/1) Nuk pajtohem plotësisht, Nuk pajtohem, Neutral – Pajtohem, Pajtohem plotësisht

**PYETJA E GJASHTË:** A i besoni thënies së mëposhtme: "Të dërguarit e SHBA-së dhe BE-së për Ballkanin Perëndimor po përpiqen të rrëzojnë Kurtin"
**BURIMI:** Sondazhi i Vendit për Kosovën nga NDI
**SHKALLA:** (0/1) Nuk pajtohem plotësisht, Nuk pajtohem, Neutral – Pajtohem, Pajtohem plotësisht

## 3 Perceptimet e demokracisë

**PYETJA E PARË:** Pavarësisht politikës ditore dhe me perspektivë nga e ardhmja, a pajtoheni që proceset demokratike në Kosovë janë të vendosura mirë dhe po shkojnë në drejtimin e duhur?
**BURIMI:** Anketa e Pulsit Publik nga UNDP
**SHKALLA:** (0-1) Nuk pajtohem plotësisht/ Nuk pajtohem/ Neutral – 0; Pajtohem/ Pajtohem plotësisht – 1

**PYETJA E DYTË:** A janë zgjedhjet në Kosovë demokratike dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare?
**BURIMI:** Anketa e Pulsit Publik nga UNDP
**SHKALLA:** (0-1) Nuk pajtohem plotësisht/ Nuk pajtohem/ Neutral – 0; Pajtohem/ Pajtohem plotësisht – 1

**PYETJA E TRETË:** A mendoni se vota juaj do të ndryshojë situatën në Kosovë?
**BURIMI:** Anketa e Pulsit Publik nga UNDP
**SHKALLA:** (0-1) Nuk pajtohem plotësisht/ Nuk pajtohem/ Neutral – 0; Pajtohem/ Pajtohem plotësisht – 1

**PYETJA E KATËRT:** A besoni se vendimmarrja në institucionet e Kosovës është gjithëpërfshirëse dhe e përgjegjshme?
**BURIMI:** Anketa e Pulsit Publik nga UNDP
**SHKALLA:** (0-1) Nuk pajtohem plotësisht/ Nuk pajtohem/ Neutral – 0; Pajtohem/ Pajtohem plotësisht – 1

## 4 Besimi tek institucionet

**PYETJA E PARË:** Ju lutemi renditni institucionet e mëposhtme nga 5 si institucioni më i besuar deri në 1 si institucioni më pak i besuar: Presidenti
**BURIMI:** Sondazhi Rajonal nga NDI

**SHKALLA:** (1-4) Shkëlqyeshëm, Mirë, Mjaftueshëm, Dobët

**PYETJA E TRETË:** Ju lutemi renditni institucionet e mëposhtme nga 5 si institucioni më i besuar deri në 1 si institucioni më pak i besuar: Qeveria
**BURIMI:** Sondazhi Rajonal nga NDI
**SHKALLA:** (1-4) Shkëlqyeshëm, Mirë, Mjaftueshëm, Dobët

**PYETJA E PESTË:** Ju lutemi renditni institucionet e mëposhtme nga 5 si institucioni më i besuar deri në 1 si institucioni më pak i besuar: Partitë politike
**BURIMI:** Sondazhi Rajonal nga NDI
**SHKALLA:** (1-4) Shkëlqyeshëm, Mirë, Mjaftueshëm, Dobët

**PYETJA E SHTATË:** Ju lutemi renditni institucionet e mëposhtme nga 5 si institucioni më i besuar deri në 1 si institucioni më pak i besuar: Gjyqësori
**BURIMI:** Sondazhi Rajonal nga NDI
**SHKALLA:** (1-4) Shkëlqyeshëm, Mirë, Mjaftueshëm, Dobët

**PYETJA E TETË:** Ju lutemi renditni institucionet e mëposhtme nga 5 si institucioni më i besuar deri në 1 si institucioni më pak i besuar: Policia
**BURIMI:** Sondazhi Rajonal nga NDI
Shkalla: (1-4) Shkëlqyeshëm, Mirë, Mjaftueshëm, Dobët

**PYETJA E NËNTË:** Ju lutemi renditni institucionet e mëposhtme nga 5 si institucioni më i besuar deri në 1 si institucioni më pak i besuar: Mjedisi mediatik
**BURIMI:** Sondazhi Rajonal nga NDI
**SHKALLA:** (1-4) Shkëlqyeshëm, Mirë, Mjaftueshëm, Dobët

**PYETJA E NJËMBËDHJETË:** Ju lutemi renditni institucionet e mëposhtme nga 5 si institucioni më i besuar deri në 1 si institucioni më pak i besuar: Forca e Sigurisë së Kosovës
**BURIMI:** Sondazhi Rajonal nga NDI
**SHKALLA:** (1-4) Shkëlqyeshëm, Mirë, Mjaftueshëm, Dobët

## Peizazhi politik

Dimensioni i peizazhit politik përdor të dhëna nga disa burime, duke përfshirë Indeksin e Varieteteve të Demokracisë, Indeksin e Perceptimit të Korrupsionit dhe anketat e ekspertëve të kryera nga ekipi hulumtues i Demokraci Plus. Dimensioni i peizazhit politik është ndarë në katër indikatorë të ponderuar në mënyrë të barabartë. Secili është renditur më poshtë së bashku me pyetjet (dhe burimet e tyre) që janë përdorur për të krijuar secilin output. Secili indikator është rishkallëzuar në mënyrë që totalet të llogariten nga totali prej 100.

### 1 Qëndrimet dhe sjelljet e udhëheqësve politikë

**PYETJA E DYTË:** Duke marrë parasysh aktivitetet dhe deklaratat e Qeverisë së Kosovës gjatë viteve të fundit, sa të brishta do t'i konsideronit marrëdhëniet ndërmjet Kosovës dhe: Rusisë
**BURIMI:** Anketa e ekspertëve nga Demokraci Plus
**SHKALLA:** 1-5 – Shumë të brishta/ Deri diku të brishta/ Neutrale/ Deri diku të normalizuara/ Shumë të normalizuara

**PYETJA E TRETË:** Duke marrë parasysh aktivitetet dhe deklaratat e Qeverisë së Kosovës gjatë viteve të fundit, sa të brishta do t'i konsideronit marrëdhëniet ndërmjet Kosovës dhe:
Kinës
**BURIMI:** Anketa e ekspertëve nga Demokraci Plus
**SHKALLA:** 1-5 – Shumë të brishta/ Deri diku të brishta/ Neutrale/ Deri diku të normalizuara/ Shumë të normalizuara

**PYETJA E KATËRT:** Duke marrë parasysh aktivitetet dhe deklaratat e Qeverisë së Kosovës gjatë viteve të fundit, sa të brishta do t'i konsideronit marrëdhëniet ndërmjet Kosovës dhe:
SHBA-së
**BURIMI:** Anketa e ekspertëve nga Demokraci Plus
**SHKALLA:** 1-5 – Shumë të normalizuara/ Deri diku të normalizuara/ Neutrale/ Deri diku të brishta/ Shumë të brishta

**PYETJA E PESTË:** Duke marrë parasysh aktivitetet dhe deklaratat e Qeverisë së Kosovës gjatë viteve të fundit, sa të brishta do t'i konsideronit marrëdhëniet ndërmjet Kosovës dhe:
NATO-s
**BURIMI:** Anketa e ekspertëve nga Demokraci Plus
**SHKALLA:** 1-5 – Shumë të normalizuara/ Deri diku të normalizuara/ Neutrale/ Deri diku të brishta/ Shumë të brishta

**PYETJA E GJASHTË:** Duke marrë parasysh aktivitetet dhe deklaratat e Qeverisë së Kosovës gjatë viteve të fundit, sa të brishta do t'i konsideronit marrëdhëniet ndërmjet Kosovës dhe:
BE-së

**BURIMI:** Anketa e ekspertëve nga Demokraci Plus
**SHKALLA:** 1-5 – Shumë të normalizuara/ Deri diku të normalizuara/ Neutrale/ Deri diku të brishta/ Shumë të brishta

**PYETJA E SHTATË:** Deri në çfarë mase veprimet e udhëheqësve politikë të Kosovës i kanë përmbushur idealet demokratike të qytetarëve?
**BURIMI:** Anketa e ekspertëve nga Demokraci Plus
**SHKALLA:** 1-5 – (1 është Më pak demokratike dhe 5 është Më demokratike)

**PYETJA E TETË:** Deri në çfarë mase deklaratat e udhëheqësve politikë të Kosovës i kanë përmbushur idealet demokratike të qytetarëve?
**BURIMI:** Anketa e ekspertëve nga Demokraci Plus
**SHKALLA:** 1-5 – (1 është Më pak demokratike dhe 5 është Më demokratike)

## 2 Kapaciteti institucional

**PYETJA E PARË:** Renditja e vendit në Indeksin e Perceptimit të Korrupsionit
**BURIMI:** Transparency International 2023
**SHKALLA:** 0/100

**PYETJA E DYTË:** Rezultati për llogaridhënien horizontale (Në çfarë mase është arritur ideali i llogaridhënies horizontale të qeverisë?)
**BURIMI:** Varietetet e Demokracisë, Indeksi i Mekanizmave të Llogaridhënies 2023
**SHKALLA:** 0/1 – (E ulët deri në E lartë)

**PYETJA E TRETË:** Rezultati për mbikëqyrjen ekzekutive (Nëse zyrtarët e degës ekzekutive u përfshinë në veprimtari jo-kushtetuese, të kundërligjshme ose jo-etike, sa gjasa ka që një organ, përveç legjislaturës, si auditori i përgjithshëm, prokurori i përgjithshëm ose avokati i popullit, t'i marrë në pyetje ose t'i hetojë ata dhe të nxjerrë vendim apo raport të pafavorshëm?)
**BURIMI:** Varietetet e Demokracisë, Indeksi i Mekanizmave të Llogaridhënies 2023
**SHKALLA:** 0/4 - Nuk ka gjasa/ Shumë e pasigurt/ Ka gjasa/ E sigurt ose pothuajse e sigurt

**PYETJA E KATËRT:** Rezultati për bindjen ndaj gjyqësorit (Sa shpesh do të thoshit se qeveria u bindet vendimeve të rëndësishme të gjykatave të tjera me të cilat nuk pajtohet?)
**BURIMI:** Varietetet e Demokracisë, Indeksi i Mekanizmave të Llogaridhënies 2023
**SHKALLA:** 0/4 – Rrallë/ Rreth gjysmën e kohës/ Zakonisht/ Gjithmonë

**PYETJA E PESTË:** Rezultati për kufizimet legjislative ndaj ekzekutivit (Në çfarë mase janë të gjendje legjislatura dhe agjencitë qeveritare, auditori i përgjithshëm, prokurori i përgjithshëm ose avokati i popullit të marrin në pyetje, të hetojnë dhe të ushtrojnë mbikëqyrje të ekzekutivit?)
**BURIMI:** Varietetet e Demokracisë, Indeksi i Mekanizmave të Llogaridhënies 2023
Shkalla: 0/1 (E ulët deri në E lartë)

**PYETJA E GJASHTË:** Rezultati për demokracinë deliberative (Në çfarë mase është arritur ideali i demokracisë konsultative?)
**BURIMI:** Varietetet e demokracisë, Indeksi i Lirive Civile dhe Mosdiskriminimit
Shkalla: 0/1 (E ulët deri në E lartë)

**PYETJA E SHTATË:** Rezultati për shpërndarjen e barabartë të burimeve
**BURIMI:** Varietetet e demokracisë, Indeksi i Lirive Civile dhe Mosdiskriminimit 2023
Shkalla: 0/1 – (E ulët deri në E lartë)

**PYETJA E TETË:** Rezultati për përjashtimin sipas grupit shoqëror-ekonomik
**BURIMI:** Varietetet e demokracisë, Indeksi i Lirive Civile dhe Mosdiskriminimit 2023
**SHKALLA:** 0/1 – (E ulët deri në E lartë)

**PYETJA E NËNTË:** Rezultati për grupin shoqëror
**BURIMI:** Varietetet e demokracisë, Indeksi i Lirive Civile dhe Mosdiskriminimit 2023
**SHKALLA:** 0/1 – (E ulët deri në E lartë)

**PYETJA E DHJETË:** Rezultati për grupin politik
**BURIMI:** Varietetet e demokracisë, Indeksi i Lirive Civile dhe Mosdiskriminimit 2023
**SHKALLA:** 0/1 – (E ulët deri në E lartë)

## 3 Cenueshmëria gjatë politikës së përditshme/ zgjedhjeve

**PYETJA E PARË:** Sa janë prevalente narrativat e dezinformimit gjatë zgjedhjeve në Kosovë?
**BURIMI:** Anketa e ekspertëve nga Demokraci Plus
**SHKALLA:** 1/5 - Shumë të pazakonshme/ Të pazakonshme/ Neutrale/ Të zakonshme/ Shumë të zakonshme

**PYETJA E DYTË:** Sa janë prevalente narrativat e dezinformimit gjatë politikës së përditshme në Kosovë?
**BURIMI:** Anketa e ekspertëve nga Demokraci Plus
**SHKALLA:** 1/5 - Shumë të pazakonshme/ Të pazakonshme/ Neutrale/ Të zakonshme/ Shumë të zakonshme

**PYETJA E TRETË:** Rezultati për polarizimin e shoqërisë (Si do t'i karakterizonit dallimet e opinioneve për çështjet kryesore politike në shoqëri?)
**BURIMI:** Varietetet e demokracisë
**SHKALLA:** 0/4 – Polarizim serioz/ Polarizim i moderuar/ Polarizim mesatar/ Polarizim i kufizuar/ Nuk ka polarizim

**PYETJA E KATËRT:** Shpërndarja e informacionit të rremë nga partitë: Brenda vendit (Sa shpesh partitë politike kryesore dhe kandidatët për detyrë publike përdorin mediat sociale për të shpërndarë pikëpamje lajthitëse ose informacione të rreme për të ndikuar në popullatën e tyre?)
**BURIMI:** Varietetet e demokracisë
**SHKALLA:** 0/4 – Jashtëzakonisht shpesh/ Shpesh/ Rreth gjysmën e kohës/ Rrallë/ Asnjëherë, apo pothuajse kurrë

## 4 Kapaciteti institucional për të menaxhuar dezinformimin e huaj

**PYETJA E PARË:** Sa e përgatitur është Qeveria e Kosovës për t'iu kundërpërgjigjur dezinformimit të huaj?
**BURIMI:** Anketa e ekspertëve nga Demokraci Plus
**SHKALLA:** 1/5 – Shumë e papërgatitur/ E papërgatitur / Neutrale / Deri diku e përgatitur/ Shumë e përgatitur

**PYETJA E DYTË:** Sikur nesër të shtoheshin përpjekjet e dezinformimit të huaj për të destabilizuar Kosovën, çfarë pritni, si do ta do ta bënte Kosova punën e menaxhimit të kërcënimit?
**BURIMI:** Anketa e ekspertëve nga Demokraci Plus
**SHKALLA:** 1/5 – Shumë dobët/ Dobët/ Pranueshëm/ Mirë/ Shumë mirë

**PYETJA E TRETË:** Sa mirë janë të përkufizuara institucionet ligjore dhe politike të Kosovës për të menaxhuar kërcënimet kibernetike?
Burimi: Anketa e ekspertëve nga Demokraci Plus
**SHKALLA:** 1/5 – Shumë dobët/ Dobët/ Pranueshëm/ Mirë/ Shumë mirë

**PYETJA E KATËRT:** Në krahasim me sfidat e tjera me të cilat ballafaqohet Kosova, sa i rëndësishëm është kërcënimi që paraqesin lajmet e rreme/dezinformimi?
**BURIMI:** Anketa e ekspertëve nga Demokraci Plus
**SHKALLA:** 1/5 - Shumë i parëndësishëm/ I parëndësishëm/ I pavendosur / I rëndësishëm/ Shumë i rëndësishëm

**PYETJA E PESTË:** A janë të disponueshme gjerësisht për qytetarët burime (qeveritare, private ose jofitimprurëse) për të kontrolluar vërtetësinë e pretendimeve potencialisht lajthitëse?
**BURIMI:** Anketa e ekspertëve nga Demokraci Plus
**SHKALLA:** Jo/Po – 0/1

# Mjedisi mediatik

Dimensioni i mjedisit mediatik përdor të dhëna nga disa burime, duke përfshirë Indeksin e Varieteteve të Demokracisë, Indeksin Botëror të Lirisë së Shtypit, rezultatet e vlerësimit PISA, anketën e Eurostat-it, të dhënat e regjistrimit të popullsisë, rezultatet e Indeksit të E-Pjesëmarrjes të OKB-së dhe anketat e ekspertëve të kryera nga ekipi hulumtues i Demokraci Plus. Dimensioni i mjedisit mediatik është ndarë në katër indikatorë të ponderuar në mënyrë të barabartë. Secili është renditur më poshtë së bashku me pyetjet (dhe burimet e tyre) që janë përdorur për të krijuar secilin output. Secili indikator është rishkallëzuar në mënyrë që totalet të llogariten nga totali prej 100.

## 1 Liria e mediave

**PYETJA E PARË:** Rezultati i vendit në Indeksin Botëror të Lirisë së Shtypit
**BURIMI:** Reporterët pa Kufij, Indeksi Botëror i Lirisë së Shtypit 2023
**SHKALLA:** 0/100

## 2 Prevalenca/ Disponueshmëria e dezinformimit për publikun

**PYETJA E PARË:** Sa prevalent është dezinformimi në mjedisin mediatik të Kosovës?
**BURIMI:** Anketa e ekspertëve nga Demokraci Plus
**SHKALLA:** 1/5 - Shumë i pazakonshëm/ I pazakonshëm/ Neutral/ I zakonshëm/ Shumë i zakonshëm

**PYETJA E DYTË:** Sa çështje serioze ka qenë dezinformimi në Kosovë?
**BURIMI:** Anketa e ekspertëve nga Demokraci Plus
**SHKALLA:** 1/5 – Shumë joserioze/ Joserioze/ Neutrale/ Serioze/ Shumë serioze

**PYETJA E TRETË:** Sa me ndikim ka qenë dezinformimi në ndryshimin e qëndrimeve në Kosovë?
**BURIMI:** Anketa e ekspertëve nga Demokraci Plus
**SHKALLA:** 1/5 – Shumë pa ndikim/ Pa ndikim/ Neutral/ Me ndikim/ Me shumë ndikim

**PYETJA E KATËRT:** Për kanalin e mëposhtëm të lajmeve, ju lutemi vlerësoni se sa serioz është kërcënimi i dezinformimit për Kosovën: Kanalet televizive private
**BURIMI:** Anketa e ekspertëve nga Demokraci Plus
**SHKALLA:** 1/5 – Shumë joserioz/ Joserioz/ Neutral/ Serioz/ Shumë serioz

**PYETJA E PESTË:** Për kanalin e mëposhtëm të lajmeve, ju lutemi vlerësoni se sa serioz është kërcënimi i dezinformimit për Kosovën: Kanalet televizive publike
**BURIMI:** Anketa e ekspertëve nga Demokraci Plus
**SHKALLA:** 1/5 – Shumë joserioz/ Joserioz/ Neutral/ Serioz/ Shumë serioz

**PYETJA E GJASHTË:** Për kanalin e mëposhtëm të lajmeve, ju lutemi vlerësoni se sa serioz është kërcënimi i dezinformimit për Kosovën: Mediat sociale
**BURIMI:** Anketa e ekspertëve nga Demokraci Plus
**SHKALLA:** 1/5 – Shumë joserioz/ Joserioz/ Neutral/ Serioz/ Shumë serioz

## 3 Kapaciteti për të menaxhuar dezinformimin

**PYETJA E PARË:** A ka qeveria staf me kualifikime të mjaftueshme teknologjike dhe burime të mjaftueshme teknologjike për të zbutur dëmet nga kërcënimet e sigurisë kibernetike?
**BURIMI:** Varietetet e Demokracisë, Indeksi i Kapacitetit të Qeverisë për Siguri Kibernetike 2021
**SHKALLA:** 0/4 – Jo/ Jo në të vërtetë/ Deri diku/ Kryesisht/ Po

**PYETJA E DYTË:** Çfarë lloj përmbajtjeje mbulohet nga korniza ligjore për qëllime të rregullimit të Internetit?
**BURIMI:** Varietetet e Demokracisë, Indeksi i Rregullimit Ligjor për Përmbajtjen në Internet 2023
**SHKALLA:** 0/4 – 0: Shteti mund të heqë çdo përmbajtje sipas dëshirës. 1: Shteti mund të heqë shumicën e përmbajtjes dhe ligji mbron lirinë e shprehjes vetëm në kontekste specifike dhe politikisht të pakontestueshme. 2: Korniza ligjore është e paqartë. Shteti mund të heqë disa përmbajtje politikisht të ndjeshme, ndërsa të tjerat mbrohen me ligj. 3: Ligji mbron pjesën më të madhe të lirisë së shprehjes politike, por shteti mund të heqë përmbajtjen posaçërisht politikisht të kontestueshme. 4: Ligji mbron lirinë e shprehjes politike dhe shteti mund të heqë përmbajtjen vetëm nëse ajo shkel kriteret ligjore të kamotshme.

**PYETJA E TRETË:** Sa efektive kanë qenë përpjekjet e qeverisë për të luftuar dezinformimin?
**BURIMI:** Anketa e ekspertëve nga Demokraci Plus
**SHKALLA:** 1/5 – Jo efektive/ Deri diku efektive/ Efektive/ Shumë efektive/ Jashtëzakonisht efektive

**PYETJA E KATËRT:** Sa efektive është korniza aktuale ligjore e Kosovës për trajtimin e dezinformimit?
**BURIMI:** Anketa e ekspertëve nga Demokraci Plus
**SHKALLA:** 1/5 – Jo efektive/ Deri diku efektive/ Efektive/ Shumë efektive/ Jashtëzakonisht efektive

**PYETJA E PESTË:** A janë institucionet e Kosovës aktualisht të afta të menaxhojnë në mënyrë efektive kërcënimin e dezinformimit?
**BURIMI:** Anketa e ekspertëve nga Demokraci Plus
**SHKALLA:** 1/5 – Nuk janë të afta/ Deri diku të afta/ Të afta/ Shumë të afta/ Jashtëzakonisht të afta

**PYETJA E GJASHTË:** Sa efektiv ishte Facebook-u (ose kompanitë e tjera të mediave sociale) në menaxhimin e kërcënimit të dezinformimit në platformën e tyre në Kosovë?
**BURIMI:** Anketa e ekspertëve nga Demokraci Plus
**SHKALLA:** 1/5 – Jo efektiv/ Deri diku efektiv/ Efektiv/ Shumë efektiv/ Jashtëzakonisht efektiv

## 4 Rezilienca e publikut ndaj keqinformimit/ dezinformimit

**PYETJA E PARË:** Sa mirë i përgatit sistemi arsimor qytetarët kosovarë që të bëjnë dallimin ndërmjet thënieve të vërteta dhe të rreme online?
**BURIMI:** Anketa e ekspertëve nga Demokraci Plus
**SHKALLA:** 1/5 - Shumë dobët/ Dobët/ Pranueshëm/ Mirë/ Shumë mirë

**PYETJA E DYTË:** Rezultati i vendit sipas Freedom House
**BURIMI:** Freedom House 2023
**SHKALLA:** 0/100

**PYETJA E TRETË:** Rezultati për lexim në vlerësimin PISA
**BURIMI:** Rezultati për lexim në PISA 2022
**SHKALLA:** 0/600

**PYETJA E KATËRT:** Rezultati për shkencë në vlerësimin PISA
**BURIMI:** Rezultati për shkencë në PISA 2022
**SHKALLA:** 0/600

**PYETJA E PESTË:** Rezultati për matematikë në vlerësimin PISA
**BURIMI:** Rezultati për matematikë në PISA 2022
**SHKALLA:** 0/600

**PYETJA E GJASHTË:** Niveli i E-Pjesëmarrjes në mesin e popullatës kosovare
**BURIMI:** Indeksi i E-Pjesëmarrjes i Kombeve të Bashkuara 2023 – Zëvendësuar me vlerën mesatare të shteteve fqinje: Mali i Zi, Serbia, Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Serbia
**SHKALLA:** Shkalla origjinale 0/1 – Rishkallëzuar në 0/100

**PYETJA E SHTATË:** Sa të sigurt jeni në njohjen se çfarë është reklamë dhe çfarë jo, kur shihni ose lexoni gjëra online?
**BURIMI:** Sondazhi i NDI 2023
**SHKALLA:** (1-5) Aspak, Jo shumë, As/As, Mjaft, Shumë

**PYETJA E TETË:** A e dini se si të identifikoni email-et ose mesazhet në media sociale (për shembull në Facebook) që përmbajnë vegëza të dyshimta dhe adresa ose emra që nuk i dini?
**BURIMI:** Sondazhi i NDI 2023
**SHKALLA:** (0-1) Po, gjithmonë – Nuk e di se çfarë janë këto email-e dhe mesazhe/ Jo, nuk e di se si të identifikoj/ Është e vështirë për mua të identifikoj email-e dhe mesazhe të tilla

# Dezinformimi me bazë gjinore

Dimensioni i ri i dezinformimit me bazë gjinore përdor të dhëna nga disa burime, duke përfshirë Sondazhet e NDI, Raportet e UN Women dhe rezultatet e vlerësimit PISA. Dimensioni i dezinformimit me bazë gjinore është ndarë në tre indikatorë të ponderuar në mënyrë të barabartë. Secili është renditur më poshtë së bashku me pyetjet (dhe burimet e tyre) që janë përdorur për të krijuar secilin output. Secili indikator është rishkallëzuar në mënyrë që totalet të llogariten nga totali prej 100.

## 1 Qëndrimet ndaj grave në politikë

**PYETJA E PARË:** Dhuna ndaj grave në politikë përkufizohet duke përfshirë të gjitha format e agresionit, shtrëngimit dhe frikësimit ndaj grave si aktore politike për shkak se ato janë gra. Ju lutemi vlerësoni sa pajtoheni ose nuk pajtoheni me thëniet vijuese: Ngacmimi online dhe portretizimi negativ i grave politikane dekurajon pjesëmarrjen e tyre politike
**BURIMI:** Sondazhi i NDI 2023
**SHKALLA:** (1-5) Pajtohem plotësisht, Pajtohem, Neutral, Nuk pajtohem, Nuk pajtohem plotësisht

**PYETJA E DYTË:** Unë kam gatishmërinë të zgjedh gratë
**BURIMI:** Sondazhi i NDI 2023
**SHKALLA:** (1-5) Pajtohem plotësisht, Pajtohem, Neutral, Nuk pajtohem, Nuk pajtohem plotësisht

**PYETJA E TRETË:** Populli i Kosovës nuk është i gatshëm të zgjedhë gratë
**BURIMI:** Sondazhi i NDI 2023
**SHKALLA:** (1-5) Nuk pajtohem plotësisht, Nuk pajtohem, Neutral, Pajtohem, Pajtohem plotësisht

**PYETJA E KATËRT:** Do të duhej të ketë përfaqësim të barabartë të grave dhe burrave në qeverinë e vendit
**BURIMI:** Sondazhi i NDI 2023
**SHKALLA:** (1-5) Pajtohem plotësisht, Pajtohem, Neutral, Nuk pajtohem, Nuk pajtohem plotësisht

## 2 Mangësitë e edukimit gjinor

**PYETJA E PARË:** A i besoni thënies së mëposhtme: "Homoseksualiteti është çrregullim apo sëmundje" (Respondentët femra)
**BURIMI:** Sondazhi i Vendit për Kosovën nga NDI
**SHKALLA:** (0/1) Nuk pajtohem plotësisht, Nuk pajtohem, Neutral – Pajtohem, Pajtohem plotësisht

**PYETJA E DYTË:** A i besoni thënies së mëposhtme: “Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe do të bëhet Republika Srpska e re në Kosovë” (Respondentët femra)
**BURIMI:** Sondazhi i Vendit për Kosovën nga NDI
**SHKALLA:** (0/1) Nuk pajtohem plotësisht, Nuk pajtohem, Neutral – Pajtohem, Pajtohem plotësisht

**PYETJA E TRETË:** A i besoni thënies së mëposhtme: “NATO dhe BE janë fajtorë për tensionet në veri të Kosovës” (Respondentët femra)
**BURIMI:** Sondazhi i Vendit për Kosovën nga NDI
**SHKALLA:** (0/1) Nuk pajtohem plotësisht, Nuk pajtohem, Neutral – Pajtohem, Pajtohem plotësisht

**PYETJA E KATËRT:** A i besoni thënies së mëposhtme: “Partnerët ndërkombëtarë po e ndëshkojnë gabimisht Kosovën” (Respondentët femra)
**BURIMI:** Sondazhi i Vendit për Kosovën nga NDI
**SHKALLA:** (0/1) Nuk pajtohem plotësisht, Nuk pajtohem, Neutral – Pajtohem, Pajtohem plotësisht

**PYETJA E PESTË:** A i besoni thënies së mëposhtme: “Të dërguarit e SHBA-së dhe BE-së për Ballkanin Perëndimor po përpiqen të rrëzojnë Kurtin”(Respondentët femra)
**BURIMI:** Sondazhi i Vendit për Kosovën nga NDI
**SHKALLA:** (0/1) Nuk pajtohem plotësisht, Nuk pajtohem, Neutral – Pajtohem, Pajtohem plotësisht

**PYETJA E GJASHTË:** Rezultati për lexim në vlerësimin PISA (Respondentët femra)
**BURIMI:** Rezultatet e vlerësimit PISA 2022
**SHKALLA:** 0/600

**PYETJA E SHTATË:** Sa të sigurt jeni në njohjen se çfarë është reklamë dhe çfarë jo, kur shihni ose lexoni gjëra online?
(Respondentët femra)
**BURIMI:** Sondazhi i NDI 2023
**SHKALLA:** (1-5) Aspak, Jo shumë, As/As, Mjaft, Shumë

**PYETJA E TETË:** A e dini se si të identifikoni email-et ose mesazhet në media sociale (për shembull në Facebook) që përmbajnë vegëza të dyshimta dhe adresa ose emra që nuk i dini?
(Respondentët femra)
**BURIMI:** Sondazhi i NDI 2023
**SHKALLA:** (0-1) Nuk e di se çfarë janë këto email-e dhe mesazhe/ Jo, nuk e di se si të identifikoj/ Është e vështirë për mua të identifikoj email-e dhe mesazhe të tilla – Po, gjithmonë

## 3 Legjislacioni në lidhje me barazinë e grave

**PYETJA E PARË:** Legjislacioni përmes Kodit Penal për DHNG/LT
**BURIMI:** Raporti i UN Women, Ana e errët e digjitalizimit
**SHKALLA:** (1-4) Nuk ka ligj apo strategji të tillë, Ligji dhe politika në rastin më të mirë trajtojnë tërthorazi disa forma të DHNG/LT, Ligji dhe politika trajtojnë drejtpërdrejt disa forma të DHNG/LT, Ligji dhe politika trajtojnë drejtpërdrejt shumicën e formave të DHNG/LT

**PYETJA E DYTË:** Ligji i posaçëm për BGJ, DHNG/DHF
**BURIMI:** Raporti i UN Women, Ana e errët e digjitalizimit
**SHKALLA:** (1-4) Nuk ka ligj apo strategji të tillë, Ligji dhe politika në rastin më të mirë trajtojnë tërthorazi disa forma të DHNG/LT, Ligji dhe politika trajtojnë drejtpërdrejt disa forma të DHNG/LT, Ligji dhe politika trajtojnë drejtpërdrejt shumicën e formave të DHNG/LT

**PYETJA E TRETË:** Strategjia e Barazisë Gjinore për DHNG/LT
**BURIMI:** Raporti i UN Women, Ana e errët e digjitalizimit
**SHKALLA:** (1-4) Nuk ka ligj apo strategji të tillë, Ligji dhe politika në rastin më të mirë trajtojnë tërthorazi disa forma të DHNG/LT, Ligji dhe politika trajtojnë drejtpërdrejt disa forma të DHNG/LT, Ligji dhe politika trajtojnë drejtpërdrejt shumicën e formave të DHNG/LT

**PYETJA E PARË:** Strategjia e posaçme për DHNG/LT
**BURIMI:** Raporti i UN Women, Ana e errët e digjitalizimit
**SHKALLA:** (1-4) Nuk ka ligj apo strategji të tillë, Ligji dhe politika në rastin më të mirë trajtojnë tërthorazi disa forma të DHNG/LT, Ligji dhe politika trajtojnë drejtpërdrejt disa forma të DHNG/LT, Ligji dhe politika trajtojnë drejtpërdrejt shumicën e formave të DHNG/LT

# Marrëdhëniet ndëretnike

Dimensioni i ri i marrëdhënieve ndëretnike përdor të dhëna nga disa burime, duke përfshirë Sondazhet e NDI, Vlerësimet e Stafit të NDI dhe Anketën e Ekspertëve nga Demokraci Plus. Dimensioni i marrëdhënieve ndëretnike është ndarë në tre indikatorë të ponderuar në mënyrë të barabartë. Secili është renditur më poshtë së bashku me pyetjet (dhe burimet e tyre) që janë përdorur për të krijuar secilin

output. Secili indikator është rishkallëzuar në mënyrë që totalet të llogariten nga totali prej 100.

## 1 Marrëdhëniet Kosovë-Serbi

Pyetja e parë: Cila nga thëniet vijuese është më e afërt me pikëpamjet tuaja, kur flisni për marrëdhëniet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë?
Burimi: Sondazhi i NDI 2023
Shkalla: (0-1) "Besoj se nuk ka interes dhe dëshirë as nga Kosova, as nga Serbia për të filluar një konflikt të armatosur"/ "Prania e NATO-s është e mjaftueshme për të parandaluar çdo rikthim në konflikt të dhunshëm ndërmjet Kosovës dhe Serbisë" – "Besoj se konflikti i armatosur mes Kosovës dhe Serbisë mund të kthehet së shpejti"

**PYETJA E DYTË:** Si kanë ndryshuar marrëdhëniet ndërmjet qeverisë së Kosovës dhe asaj të Serbisë gjatë vitit të fundit?
**BURIMI:** Anketa e ekspertëve nga Demokraci Plus
**SHKALLA:** (1-5) Shumë më mirë, Më mirë, Njëjtë, Më keq, Shumë më keq

**PYETJA E TRETË:** Me perspektivën pas disa vite nga sot, a prisni që marrëdhëniet etnike brenda Kosovës të përmirësohen, të përkeqësohen apo të mbeten njëjtë?
**BURIMI:** Sondazhi i NDI 2023
**SHKALLA:** (0-1) Përmirësohen/ Mbeten njëjtë – Përkeqësohen

## 2 Tensionet ndëretnike

**PYETJA E PARË:** Deri në çfarë mase pajtoheni me thëniet vijuese? Rusia mbështet serbët e Kosovës
**BURIMI:** Sondazhi i FCDO 2023
**SHKALLA:** (1-4) Nuk pajtohem plotësisht, Nuk pajtohem, Pajtohem, Pajtohem plotësisht

**PYETJA E DYTË:** Deri në çfarë mase pajtoheni me thëniet vijuese? BE-ja mbështet serbët e Kosovës
**BURIMI:** Sondazhi i FCDO 2023
**SHKALLA:** (1-4) Pajtohem plotësisht, Pajtohem, Nuk pajtohem, Nuk pajtohem plotësisht

**PYETJA E TRETË:** Deri në çfarë mase pajtoheni me thëniet vijuese? SHBA-ja mbështet serbët e Kosovës
**BURIMI:** Sondazhi i FCDO 2023
**SHKALLA:** (1-4) Pajtohem plotësisht, Pajtohem, Nuk pajtohem, Nuk pajtohem plotësisht

**PYETJA E KATËRT:** Deri në çfarë mase pajtoheni me thëniet vijuese? Mbretëria e Bashkuar mbështet serbët e Kosovës
**BURIMI:** Sondazhi i FCDO 2023
**SHKALLA:** (1-4) Pajtohem plotësisht, Pajtohem, Nuk pajtohem, Nuk pajtohem plotësisht

**PYETJA E PESTË:** A besoni se ka gjasa të bëhet luftë në Ballkan?
**BURIMI:** Sondazhi i FCDO 2023
**SHKALLA:** (1-3) Nuk ka gjasa, Deri diku ka gjasa, Ka shumë gjasa

**PYETJA E GJASHTË:** Si do ta vlerësonit nivelin e harmonisë dhe mirëkuptimit ndërmjet grupeve të ndryshme etnike në Kosovë, në shkallë nga 1 deri në 5, ku 1 përfaqëson marrëdhënie shumë të dobëta dhe 5 përfaqëson marrëdhënie shumë të mira?
**BURIMI:** Anketa e ekspertëve nga Demokraci Plus
**SHKALLA:** (1- 5) Shumë dobët, Dobët, Neutral, Mirë, Shumë mirë

## 3 Dezinformimi me synim

**PYETJA E PARË:** Gjatë vitit të kaluar, sa prevalente ishin narrativat e huaja të dezinformimit me synim popullsinë shqipfolëse në Kosovë?
**BURIMI:** Anketa e ekspertëve nga Demokraci Plus
**SHKALLA:** (1-5) Shumë të pazakonshme, Deri diku të pazakonshme, As-As, Deri diku të zakonshme, Shumë të zakonshme

**PYETJA E DYTË:** Gjatë vitit të kaluar, sa prevalente ishin narrativat e huaja të dezinformimit me synim popullsinë shqipfolëse në Kosovë?
**BURIMI:** Stafi i NDI
**SHKALLA:** (1-3) Neutral/Deri diku të zakonshme/Shumë të zakonshme

**PYETJA E PARË:** Gjatë vitit të kaluar, sa prevalente ishin narrativat e huaja të dezinformimit me synim popullsinë serbishtfolëse në Kosovë?
**BURIMI:** Anketa e ekspertëve nga Demokraci Plus
**SHKALLA:** (1-5) Shumë të pazakonshme, Deri diku të pazakonshme, As-As, Deri diku të zakonshme, Shumë të zakonshme

**PYETJA E DYTË:** Gjatë vitit të kaluar, sa prevalente ishin narrativat e huaja të dezinformimit me synim popullsinë serbishtfolëse në Kosovë?
**BURIMI:** Stafi i NDI
**SHKALLA:** Neutral/Deri diku të zakonshme/Shumë të zakonshme

This report has been published by the Democracy Plus Institute (D +) as part of the project "Vulnerability Index of Disinformation", which is supported by the National Democratic Institute - NDI and the United States Agency for International Development - USAID. The content of this report belongs to the Democracy Plus Institute and does not necessarily reflect the position of NDI and USAID.

USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA

NDI
NATIONAL DEMOCRATIC INSTITUTE